



**PSSP-ja Jessen-Peterseni
i drejtohet Kuvendit në
sesionin inagural**

**Gjashtë qëllimet e
NDI-së në përkrahjen
e Kuvendit**

Džezair Murati:

“Komunitetet minoritare do të tregojnë pjekuri”

Editorial



Rendi i ditës për përbërjen e re të Kuvendit të Kosovës

Pas seancës inauguruese të Kuvendit të Kosovës me 3 dhjetor 2004, dolën në shesh sfidat e reja të Kuvendit gjatë mandatit të dytë të IPVQ-ve. Zgjedhja e qeverisë së koalicionit, që varet nga përkrahja e partive shumicë në Kuvend (LDK, AAK, PSHDK, KDTP, VAKAT dhe IRDK), por që ballafaqohet me opozitën parlamentare (PDK, ORA dhe partitë më të vogla), shënon një fazë të re në zhvillimin e procesit politik në Kosovë. Çfarë do të thotë kjo për Kuvendin dhe funksionimin e tij gjatë viteve vijuese?

Një nga detyrat e para dhe kryesore të Kuvendit është që ta miratojë legjislacionin e propozuar nga qeveria. Kështu, gjatë mandatit të parë, Kuvendi i ka miratuar afro 80 ligje. Ndërsa, pritet që të bëhet edhe prioritetizimi i llojit të legjislacionit, që do të nevojitet për të ardhmen. Gjatë mandatit të parë të IPVQ-ve, Kuvendi ka siguruar kontributin e ekspertëve dhe shoqërisë civile përmes dëgjimeve publike. Me rastin e mbajtjes së fjalimit përpara Kuvendit më 3 dhjetor, PSSP Soren Jesen-Petersen e ka inkurajuar Kuvendin që ta vazhdojë punën e vet në këtë drejtim. S'do mend se qëllimi i të gjitha grupeve parlamentare është të nxjerrin ligje që do të jenë në pajtim me standardet evropiane të legjislacionit. Projekti që e përkrah Kuvendin, i financuar nga Agjencioni Evropian për Rindërtim, do të vazhdojë me mbështetjen e Kuvendit në këtë lëmë. Pos kësaj, është me rëndësi të veçantë që ligjet e miratuara dhe të shpallura të zbatohen. Një sondazh i bërë kohë më parë nga ana e Misionit të OSBE-së në Kosovë, nxorri në shesh mangësi serioze (shih artikullin e posaçëm në këtë buletin). Është detyrë e Kuvendit që ta kontrollojë Qeverinë gjatë procesit të implementimit të ligjeve, pasi të miratohen ato nga Kuvendi.

Në këtë mënyrë, ne po kalojmë tek detyra e dytë kryesore sipas rëndësisë që ka Kuvendi: Kërkimi i përgjegjësive nga Qeveria. Prandaj, Kuvendi mund ta ushtrojë të drejtën e vet të "mbikëqyrjes së ekzekutivit" jo vetëm në miratimin e ligjeve dhe zbatimin e tyre, por edhe në fushën e zhvillimit të politikave, qeverisjes së mirë dhe transparencës. Mandati i parë i IPVQ-ve është karakterizuar me

ushtrim të dobët të funksionit të kontrollit parlamentar. Ndërsa, tani mund të pritet që opozita parlamentare t'i shfrytëzojë të gjitha instrumentet e parapara me Kornizën Kushtetuese dhe Rregulloren e Punës për ta vëzhguar me kujdes punën e Qeverisë. Megjithatë, edhe anëtarët e partive që e përkrahin Qeverinë mund të jenë të interesuar për sigurimin e qeverisjes së mirë dhe transparencës, meqë nga ata pritet që t'i përcaktojnë normat sipas të cilave Kosova do të vlerësohet në muajt dhe vitet e ardhshme.

Në këtë aspekt, zhvillimi i një kulture politike që bënë të mundur krijimin e një qeverije përgjegjëse dhe të një opozite konstruktive paraqet një sfidë të veçantë. Qeveria me përgjegjësi, siç mund ta vlerësojë dikush, do ta vazhdojë punën rreth zhvillimit të proceseve transparente dhe demokratike të vendimarrjes dhe njëherësh do ta vazhdojë punën për realizimin e Standardeve. Qeveria përgjegjëse e merr përgjegjësinë për kërkesat e popullatës për përmirësimin e kushteve të jetës. Ndërsa, nga opozita konstruktive mund të pritet që ta mbikëqyrë respektimin e Rregullores së Punës dhe politikave të qeverisjes së mirë nga ana e Qeverisë. Kështu që, opozita konstruktive e vlerëson veprimtarinë e Qeverisë në saje të meritave të saja dhe i ofron alternativat e saja të politikave.

Detyra e tretë e përbërjes së re të Kuvendit është që ta shqyrtojë dhe miratojë Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës. Ndërsa, USAID / Bearing Point mëton që edhe më tutje ta vazhdojë përkrahjen për procesin buxhetor në Kuvend, zhvillimin e procesit transparent në alokimin e suficitit buxhetor dhe kontrollit efektiv të secilës organizatë buxhetore përmes, pos tjerash, edhe rishikimeve dhe revidimeve gjysëm vjeçare të buxhetit.

Nën ombrellën e "Iniciativës për përkrahje të Kuvendit" (ASI), dhjetë organizata dhe parlamente – nga Evropa, SHBA-të ose të anëtarësuar në OKB – janë duke përgatitur programe plotësuese dhe të përbashkëta për ta përmirësuar profesionalizmin e Kuvendit si institucion. Partneriteti, është fjala kyçe dhe mënyra e vetme, që do të bëjë të mundur përgatitjen dhe zhvillimin e aktiviteteve përkrahëse, të cilat do t'i plotësojnë nevojat e Sekretariatit të Kuvendit si dhe grupeve dhe komisioneve të ndryshme parlamentare.

Në fund, është me rëndësi të vihet në dukje se Kuvendi i Kosovës tanimë është Kuvend shumetnik, në të cilin i gëzojnë të drejtat e plota të pjesëmarrjes anëtarët e komunitetit boshnjak, turk, rom dhe komuniteteve tjera minoritare. Deputetët serbë të Kuvendit të Kosovës ende nuk po marrin pjesë në punën e këtij institucioni. Megjithatë, siç vuri në dukje PSSP Jesen-Petersen, pjesëmarrja aktive e deputetëve serbë të Kuvendit të Kosovës është e domosdoshme për hir të popullatës serbe të Kosovës. Prandaj, pjesëmarrja në institucione, mbetet mënyra më e mirë për të përmirësuar kushtet e jetës.

Ky buletin sjell informata dhe analiza mbi zhvillimet dhe sfidat e fundit në Kuvend si dhe për programet e ndërtimit të kapaciteteve që kanë të bëjnë me Kuvendin. Shpresojmë se do të jetë i dobishëm për ju.

Frenklin De Vrieze,

Koordinator i "Iniciativës për përkrahje të Kuvendit"

(ASI-Assembly Support Initiative)

Fjalimi i PSSP-së me rastin e sesionit inaugurues të Kuvendit

Søren Jessen-Petersen,

Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm të KB-ve, 3 dhjetor 2004

Jam i nderuar që marr pjesë në këtë seancë inauguruuese të Kuvendit dhe shfrytëzoj rastin që menjëherë t'ju uroj që jeni zgjedhur.

Më lejoni që fillimisht ta falenderoj Qeverinë e kaluar, të udhëhequr nga kryesministri Rexhepi, për punën e saj gjatë viteve të shkuara. Ajo Qeveri ndërmori hapa të rëndësishëm për t'i shpënë përpara çështjet me rëndësi për Kosovën dhe arriti një përparim të rëndësishëm në rimëkëmbjen nga dhuna e tmerreshme e marsit të kaluar.

Zgjedhjet e Tetorit që ju sollën juve këtu, ishin parashikuar dhe përcaktuar të jenë të lira dhe të drejta, ndaj dhe u zhvilluan në mënyrë paqësore. Ato ishin një nder i vërtetë për Kosovën. Seanca e sotme është pasqyrim i këtij procesi zgjedhor.

Si deputetë të organit më të lartë përfaqësues dhe legjislativ të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes, jukenin një përgjegjësi të madhe jo vetëm ndaj votuesve tuaj, që shprehën besimin e tyre ndaj juve, por edhe ndaj Kosovës si tërësi. Ndaj dhe është përgjigjësi e juaja që të merrni vendime të bazuara në informim të drejtë dhe në mënyrë të ndërgjegjshme dhe që janë në interes të të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Unë sapo u ktheva nga Nju Jorku, ku pata rastin që shkurtimisht ta informoj Këshillin e Sigurimit si për situatën në Kosovë, ashtu edhe për vlerësimin tonë për përparimin dhe për mënyrën si të shkohet përpara. Kam kënaqësinë që t'ju tregoj se kam marrë përkrahje të fuqishme lidhur me strategjinë e ecjes përpara. Kjo do të thotë që pritet shumë nga Kosova dhe besohet në forcat dhe vullnetin e Kosovës për të arritur përparim të njëmendët në përmbylljen e standardeve, në mënyrë që të hapet rruga për vlerësim pozitiv në mesin e vitit 2005 dhe

për procesin paqësor që shpie drejt bisedimeve për status. Tani rezultati varet nga ju. Së këndejmi, është shumë me rëndësi që Kuvendi dhe Qeveria e re të fillojnë të funksionojnë menjëherë. Ndërsa, UNMIK-u është i gatshëm t'ju mbështesë në këtë detyrë.

Siç e dini, jetësimi i standardeve duhet të jetë prioritet për IPVQ-ët gjatë muajve të ardhshëm, në mënyrë që të garantohet progres i mjaftueshëm para vlerësimit të përgjithshëm të planifikuar për mesin e vitit 2005. Kuvendi do të luajë rolin kryesor në miratimin e legjislationit që është shumë i rëndësishëm për përmbylljen e standardeve. Megjithatë, është një lloj i rëndësishëm që procesi legjislativ të zbatohet në mënyrë të hapur, demokratike dhe të përgjegjshme në pajtim të plotë me Kornizën Kushtetuese. Edhe ky është një nga standardet kryesore.

Kuvendi i mëparshëm shpeshherë ka mbajtur seanca dëgjimore për t'u konsultuar me ekspertët vendas dhe me qytetarët për projektligje dhe çështje të tjera të interesit të përgjithshëm, ndaj ju inkurajoj që ta vazhdoni këtë traditë. Institucionet e Përkohshme duhet të arrijnë deri te publiku i gjerë, t'i dëgjojnë shqetësimet dhe problemet e tyre dhe të impenjohen për zgjidhjen e tyre.

Në të vërtetë, standardet kërkojnë që procesi legjislativ t'u përshatet shqetësimeve dhe mendimeve të të gjitha bashkësive të Kosovës. Për një numër shkaqesh, pjesëmarrja e serbëve të Kosovës në zgjedhje ishte fatkeqësisht e ultë, por ende ka vend për pjesëmarrje aktive të të gjitha bashkësive të Kosovës, në kryesi dhe komisione të Kuvendit.

Është përgjegjësi e secilit deputet të Kuvendit, e jo vetëm e komisioneve ose organeve të caktuara, që merren nergut me interesat



Søren Jessen-Petersen

e komuniteteve, që t'i kushtojë vëmendje të duhur propozimeve. Është përgjegjësi e të gjithë juve që ta bëni Kosovën vend më të mirë për të gjithë banorët e saj.

Siç e dini, UNMIK-u synon t'i bartë të gjitha kompetencat, që nuk kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me sovranitetin, tek Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes sa më shpejtë që të jetë e mundur. Formimi i tri ministrive të reja – për kthim dhe bashkësi, energji e miniera dhe pushtet lokal – do të pasojë me bartje të mëtutjeshme të kompetencave, në veçanti në fushën e ekonomisë dhe përfundimisht edhe në fushat që kanë të bëjnë me drejtësinë dhe sigurinë. UNMIK- u dhe Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes duhet të kenë qasje të përbashkët dhe në partneritet të përcaktojnë strategjinë më të mirë për bartjen e kompetencave.

Megjithatë, bartja e kompetencave ka kuptim vetëm nëse ajo shpie në veprime produktive dhe pozitive. Prandaj, kompetencat shtesë nënkuptojnë llogari

dhe përgjegjësi më të madhe, posaçërisht duke marrë parasysh nevojën për të arritur progres në standarde. Jam plotësisht i përgatitur që t'i përdor të gjitha mjetet dhe masat që i kam në dispozicion që aktivisht ta zbatoj përgjegjësinë e Institucioneve të Përkohshme.

Këto mjete përfshijnë vëzhgimin dhe mbikëqyrjen e fortë, por edhe sanksionet eventuale. Prandaj, jam i gatshëm t'i kundërvihem zyrtarëve që dështojnë t'i zbatojnë detyrat e tyre me përgjegjësi, ose që i bllokojnë përpjekjet për të bërë përmirësime në fushat kryesore, si të drejtat e pakicave, liria e lëvizjes, ofrimi i shërbimeve në mënyrë të barabartë, media të përgjegjshme, dhe siguri. Llogaris në mbështetjen e vazhdueshme të Institucioneve të Përkohshme në zbatimin e kësaj politike dhe të veprimeve specifike.

Po kështu, jam plotësisht i bindur se transferi i suksesshëm i kompetencave do të kërkojë ndërtimin e kapaciteteve shtesë brenda Institucioneve të Përkohshme. Pikërisht për këtë arsye, kam ndërmarrë edhe nismën për t'i mobilizuar donatorët, që të siguroj ndihmën e tyre për Institucionet e Kosovës.

S'do mend se 12 muajt e ardhshëm do të jenë vendimtarë për përcaktimin e të ardhmes së Kosovës. Së këndejmi, puna e Kuvendit, e koalicionit qeveritar si dhe e opozitës parlamentare, do të përcaktojë në një masë të madhe, nëse Kosova korr sukses apo dështon. Mirëpo, dështimi nuk është opcion. Prandaj, vetëm puna e zellshme, veprimet e drejta dhe progresi në të mirë të Kosovës do t'na bëjnë të mundur që t'ia dalim mbanë realizimit të këtyre objektivave.

Ju falemnderit që më ftuat të flas dhe ju dëshiroj sukses në punën tuaj!"


Parlamenti i karakteristikave evropiane

Shkruan Akademik Nexhat Daci, Kryetar i Kuvendit të Kosovës

Parlamenti i Kosovës i dalë nga zgjedhjet e 23 tetorit 2004, të cilat u vlerësuen të lira, demokratike e fer, për të parën herë në historinë e këtij vendi u ba me pozitë dhe opozitë. Kjo erdhi si rezultat i një koalicioni qeveritar të arritur ndërmjet partisë së parë dhe partisë së tretë të llogaritur nga fuqia e votave dhe e numrit të ulseve të fituara në Kuvendin e Kosovës dhe e grupacionit Gjashtë plus, që reprezenton komunitetet turke, boshnjake... dhe e disa partive më të vogla të skenës kosovare. Në raportin e krijuar të qeverisjes, partia e tretë e mori postin e kryeministrit si dhe katër ministri në Qeverinë e Kosovës. Para pak ditësh në një seancë plenare, shumë korrekte dhe shumë përmbajtësore, u aprovua edhe Programi Qeveritar mbas një debati të frytshëm dhe mbas një votimi që ishte në harmoni me forcën e koalicionit.

Gjendja e re e krijuar solli një cilësi të re, një respektim ndërmjet deputetëve dhe grupeve parlamentare, një seriozitet në përgaditjen për diskutim, në pjesën më të madhe me shkrim, dhe një konstruktivitet në propozime, që me të drejtë linte përshtypjen se i gjithë Parlamenti është unik në një qëllim të përbashkët, të mbështjtes së Qeverisë dhe të programit të saj dhe që është e kuptueshme, në shërbim të interesit të vendit dhe të të gjithë qytetarëve të Kosovës pa dallim.

Një e re tjetër ishte instituti i dhënies së betimit, si për deputetët ashtu edhe për Qeverinë dhe kjo u bë në mënyrë publike, përpara miliona shikuesve që e përcillnin seancën përmes ekranit



Prof. Nexhat Daci

televiziv. Ishte një akt i ndjenjës së përgjegjesisë morale i fjalës së dhënë përpara popullit dhe institucioneve se të gjithë me përkushtimin e ndershmërinë më të madhe do të punojmë në realizimin e objektivave që e presin Kosovën e të cilat nuk janë të vogla dhe që janë me peshë vetëm jo vetëm për ne por edhe për gjithë rajonin.

Në periudhën e ardhëshme Parlamenti i Kosovës pritet të jetë shumë më efikas në miratimin e ligjeve, përmes të cilave për qytetarët ofrohen zgjidhje më të përshtatshme që ua lehtësojnë

atyre kushtet e jetës e të punës, ndërsa Kosova unifikohet me legjislacionin evropian, gjë që e shkurton kohën dhe procedurat që ne së shpejti të jemi pjesë e Bashkimit Evropian, synim ky i kahershëm i popullit të Kosovës. Komoditeti i votës së nevojshme gjatë procesit të votimit të ligjeve, krijon edhe rehatin e punimit të këtyre ligjeve dhe të një bashkëpunimi të dobishëm ndërmjet Qeverisë, Parlamentit, UNMIK-ut dhe të institucioneve të ndryshme që ndihmojnë në hartimin e ligjeve. Tash më nuk do të ndodhemi në situatë që të ndryshohet

thelbi i ligjit gjatë punës në Parlament apo që ligji të mos miratohet nga Kuvendi, sepse secili është i kyqur në të gjitha fazat dhe secili e jep kontributin me qëllim të përmirësimit të cilësisë dhe të profesionalizmit duke pasur qëllim e synim të njejtë. Edhe bashkëpunimi me misionin ndërkombëtar për një partneritet të mirëfilltë dhe për një bartje të efektshme të kompetencave të institucionet e Kosovës do të realizohet sipas planit dhe dinamikës së paraparë dhe të marrur vesh,

E gjithë kjo Kosovën e bënë një vend normal dhe të zakonshëm si secilin vend tjetër të Evropës. Kjo e bënë të suksesshëm misionin ndërkombëtar të vendosur në Kosovë nga KS të OKB, me referencat më të mira për misione të tjera të ngjashme, ndërsa populli i Kosovës e merr plotësisht fatin në duart e veta, me institucionet e zgjedhura dhe me respektimin e plotë në normave dhe standardeve evropiane që bënë jo vetëm integrimin e qytetarëve por edhe të vendit në strukturat euroatlantike.



"S'do ta lemë të qetë koalicionin"

Ramë Buja ka shumë vite që është mjaft aktiv në jetën politike të Kosovës. Ai ka qenë anëtar i delegacionit të Kosovës në bisedimet e Rambujesë (1999), ndërsa me 23 tetor 2004, ai u zgjodh deputet i Kuvendit të Kosovës nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK). "Buletini e ASI-it" zhvilloi një intervistë me rastin e emërimit të tij si njërin nga dy anëtarët e Kryesisë nga radhët e PDK-ës.

A jeni të kënaqur me rezultatet e zgjedhjeve?

Meqë PDK-ja synonte të bëhej Partia më e madhe në këto zgjedhje, ne nuk mund të jemi të kënaqur me vendin e dytë. Megjithatë, ne e kemi pranuar rezultatit e zgjedhjeve. Ne jemi të vetëdijshëm për pozitën aktuale që e kemi dhe për rolin e ri që do ta luajmë, si opozitë.

Është hera e parë që Kuvendi ka një koalicion qeverisës dhe opozitë. Çfarë do të jetë tani qasja e PDK-së si parti opozitare?

Kosova po hyn në një fazë të re të demokracisë parlamentare, ku qeveria i ka sfiduesit e vet. Prandaj, ne si opozitë s'do ta lemë të qetë koalicioni qeveritar për asnjë çast. Me fjalë dhe veprimtari pozitive ne do t'i kontribuojmë zhvillimit të Kosovës. PDK-ja, nuk do te jetë vetëm një kritikuese apo edhe vetëm një subjekt që do votojë, për ose kundër. Ne do te jemi shumë aktivë si alternativë, me propozime dhe ide te reja dhe produktive.

Shpresoni të bashkëpunoni me koalicionin qeveritar?

Për të bashkëpunuar duhet të tregojnë gatishmëri të dy palët. Pa dyshim se ne jemi te gatshëm dhe kemi vullnet, për aq sa lejojnë tani pozicionet tona rivale, për të punuar për të mirën e përgjithshme të Kosovës.

A mendoni se një qeveri me bazë të gjerë të përfshirjes do të ishte më e pranueshme duke pasur parasysh rëndësinë që ka viti 2005?

Pas zgjedhjeve të 23 tetorit 2004 PDK-ja propozoi që të formohej një qeveri e spektrit të gjerë politik dhe etnik. Arsyet e këtij propozimi i kemi bërë të njohura dhe i kemi elaboruar shumë mirë. Me atë rast, ne patëm theksuar se Kosovës edhe për këtë mandat



Ramë Buja

qeverisës i nevojitet vazhdimësia politike dhe krijimi i atmosferës akoma më tolerante ndërpartiake dhe ndëretnike. Këtë propozim e kemi bërë me qëllim që të jemi së bashku në vitin 2005, në kohën kur pritet që të gjithë mekanizmat relevant ndërkombëtar do të impenjojnë më seriozisht rreth zgjidhjes së statusit perfundimtar të Kosovës.

Në pranverë të vitit 2004, mbledhjet plenare të Kuvendit janë riorganizuar dhe tani në vend të seancave javore kemi seanca mujore. Çfarë mendoni ju për këtë?

Veprimtaria e Kuvendit do të duhej të ishte e rregullt dhe e dendur, pa e paracaktuar si punë të përjavshme apo të përmuajshme. Pra, do të duhej të ishte në përputhje me detyrat dhe obligimet që dalin nga sfondi legjislativ.

Në fushatën parazgjedhore shumë parti politike premtuan se brenda vitit Kosova do të ketë kushtetutën e re. A mendoni se kjo është e mundur?

Përqindja e përmbushjes së premtimeve të dhëna në fushatën parazgjedhore është shumë e ulët, veçanërisht në Ballkan. Por, ky premtim konkret, është i mundshëm, por praktikisht është vështirë të realizohet, në mos i pamundur për kohën e premtuar, për shkak të rrjedhës së çuditshme të punëve në koalicion.

Në çfarë mënyre mendoni që Kuvendi do të mbikëqyrë përmbushjen e standardeve nga Qeveria?

S'do mend se, Kuvendi do ta mbikëqyrë përmbushjen e standardeve nga Qeveria, sipas rrjedhës logjike dhe legale, ashtu si bënë edhe mbikëqyrjen e veprimeve, funksinimit dhe angazhimeve të tjera të Qeverisë. Mirëpo, sa i takon ngecjeve eventuale në të cilat mund të hasë Qeveria gjatë procesit të zbatimit të tyre, mbase do të ishte e udhës që të organizohen edhe debate parlamentare. U muar vesh kjo do të bëhej në kuadër të përpjekjeve për përsheptimin e përmbushjes të sa më parshëm të standardeve priori-

tare, për arritjen e të cilave më të interesuarit jemi ne qytetarët e Kosovës. Nëse me të vërtetë duam t'i plotësojmë kushtet për fillimin e negociatave për zgjidhjen e statusit të Kosovës, ne duhet të sigurojmë një bashkëpunim të mirëfillt me UNMIK-un.

Cilat janë prioritetet e Kuvendit?

Angazhimi i Kuvendit është i ditur dhe i përcaktuar qartë. Detyrë e tij imediate dhe parësore është sigurimi i bazës së mjaftueshme dhe përmbajtësore ligjore me qëllim që të bëhet e mundur përmbushja sa më e shpejtë dhe më e sukseshme e standardeve.

Si do ta ndihmoni ju si anëtarë i kryesisë së Kuvendit punën e komisioneve?

Përveç obligimeve të tjera, kësaj radhe do të fusim një cilësi të re organizative dhe vepruese për anëtarët e kryesisë së Kuvendit. Ndonëse nuk do të jenë drejtpësdrejt të angazhuar në komisione të ndryshme, anëtarët e kryesisë, megjithatë do të jenë koordinator të komisioneve dhe të bashkëpunimit midis komisioneve, në mënyrë që ta përsheptojnë punën dhe efikasitetin e Kuvendit.

Çfarë sugjerimesh keni për përmirësimin e kontrollit të ekzekutivit nga ana e Kuvendit?

Do të dëshiroja që njëherë e përgjithmonë midis institucioneve të Kosovës të instalohet fryma e bashkëpunimit dhe e koordinimit. Me t'u arritur kjo, të gjitha proceset tjera do të ecnin tabanit legal dhe institucional. Kësisoj edhe çështja e vartësisë dhe ndërvartësisë, obligimit dhe detyrimit, përgjegjësisë dhe ndërgjegjshmërisë, do të ishin paraprakisht të njohura dhe të matshme.

"Komunitetet minoritare do të tregojnë pjekuri"

Džezair Murati, kryetar i koalicionit VAKAT, është anëtar i ri i Kryesisë së Kuvendit, dhe i përfaqëson komunitetet jo-shqiptare dhe jo-serbe. "Buletini ASI" e ka intervistuar Z. Murati pas mbledhjes së parë të Kryesisë si vijim i seancës inauguruese të Kuvendit.

Z. Murati, Vakati ka tri vende në Kuvend. A jeni të kënaqur me rezultatet e zgjedhjeve?

Ne kemi pritur që t'i fitojmë tri vende dhe Vakati fitoi tri vende. Shumë entitete politike nga komuniteti ynë morrën pjesë në zgjedhje dhe si rezultat i kësaj elektorati ynë u nda. Shumë vota i morrën entitetet të cilat nuk mundën të fitonin vende në parlament, me përjashtim të SDA-së të cilës i takoi një vend i rezervuar. Është e qartë se Vakati është fitues përbrenda komunitetit boshnjak. Kjo do të thotë se ne do të jemi bartës të vendeve në Komisione, Ministri (Ministrinë e shëndetësisë), dhe pozitës me rotacion në Kryesinë e Kuvendit. Zgjidhja më e mirë e mundshme për komunitetin tonë është që të krijohet një elektorat i përbashkët, me qëllim që të përfaqësohet në mënyrën më të mirë të mundshme në Kuvendin qendror dhe në kuvendet komunale. Zgjedhjet duhet të bëhen mësim për komunitetet minoritare që të mos i përsërisin gabimet e ndarjes së elektoratit.

Kuvendi përbëhet nga partitë në pozitë dhe opozita. Çfarë do të jetë roli juaj në këto rrethana politike?

Koalicioni ynë Vakati, që me partinë turke KDTP e ka formuar grupin parlamentar 6+, ka një rol të madh. Në Kryesinë e Kuvendit e kemi një ekuilibër të forcave 3 me 3, nëse i lëmë anash përfaqësuesit e serbëve të Kosovës, sepse këta deputetë ende po e bojkotojnë punën e Kuvendit. Në njerën anë kemi PDK-në dhe ORA-n, dhe në anën tjetër gjenden LDK-ja dhe AAK-ja. Përfaqësuesi ynë mundet ta japë votën vendimtare. Ne jemi pjesë



Džezair Murati

e koalicionit qeverisës. Ndonëse mund të kemi mospajtime me qeverinë sa i përket interesave të komuniteteve tjera, kur viederi te votimi ne do të duhet t'i përkrahim vendimet e koalicionit qeverisës. Opozita duhet ta kuptojë se ky është vendimi politik që duhet ta marrin komunitetet e tjera dhe se kjo e shpreh vullnetin politik të komuniteteve të tjera. Barra që e bartim në krahët tanë është shumë e rëndë.

A e prisni bashkëpunimin në mes të pozitës dhe opozitës?

Dallimi thelbësor në mandatin e dytë të Kuvendit, krahasuar

me atë të parin ku qeveriste një koalicion i gjerë i partive shqiptare, është se tani e kemi koalicionin qeverisës të përbërë nga dy parti shqiptare (të parën dhe të tretën sipas madhësisë) plus Komunitetet e Tjera, derisa partia shqiptare e dytë dhe e katërt sipas madhësisë kanë mbetur në opozitë. Dikush mund të mendojë se koalicioni më i gjerë do të ishte më i suksesshëm. Unë besoj se sa herë ka konkurrencë, si në ekonomi ashtu edhe në politikë, gjërat shkojnë para. Konstruktiviteti i opozitës do t'i bëjë presion koalicionit qeveritar që të bëjë lëvizje cilësore. Nëse në ndonjë

situatë të caktuar ne nuk do të ofrojmë zgjidhjet më të mira, zgjidhjen më të mirë do t'ia ofrojë publikut opozita dhe në atë rast kjo do të jetë në dobi të opozitës. Kjo është edhe një arsye për të qenë i kujdesshëm. Sa herë që ne nuk e kemi zgjidhjen më të mirë opozita do të bëjë që ne të mundohemi dhe ta gjejmë atë. Opozita e ka një rol pozitiv pasi që kjo do ta bëjë koalicionin qeveritar që të jetë më i përqendruar, të mendojë dhe punojë në mënyrë cilësore.

Si e vlerësoni forcën e koalicionit qeveritar kur kemi parasysht vlerësimin e zbatimit të Standardeve nga mesi i vitit 2005?

Viti 2005 është vit i testit të madh të pjekurisë sonë, jo vetëm për koalicionin dhe opozitën por edhe për të gjitha institucionet e Kosovës dhe për Kosovën si shoqëri, ku gjendet tani dhe ku dëshiron të gjendet në të ardhmen. Do të varet shumë nga mënyra se si do t'i përcaktojmë prioritetet. Fillimisht, po fillon decentralizimi dhe komunitetet minoritare e kanë një rol të madh për ta luajtur, për t'u siguruar se të drejtat specifike të minoriteteve do të plotësohen. E dyta, është zbatimi i standardeve, që përsëri ka të bëjë me të drejtat e njeriut të komunitetit shumicë dhe atyre pakicë. Para nesh janë edhe shumë teste të tjera, siç janë kushtet e rënda të jetesës të qytetarëve të Kosovës, papunësia, ekonomia në nivel të palakmuar, mungesa e prodhimitarisë. Procesi i zhvillimit do të fillojë të lëvizë në varësi nga aftësia e entiteteve politike dhe prej negociatave në mes të Prishtinës dhe Beogra-

dit. Qeveria e ka shprehur qartë gatishmërinë e vet për fillimin e negociatave. Ekzistojnë shumë çështje të paqarta për t'u zgjidhur, çështje politike por edhe ekonomike siç janë prona, funksionimi i fabrikave, rryma, çështja e borxheve dhe investimeve.

Ne si komunitet pakicë jemi të vetëdijshëm për përgjegjësinë që kemi. Ne përfaqësojmë komunitetet minoritare që janë konstruktive dhe që e pranojmë Kosovën si shtëpinë tonë. Këtë e kemi dëshmuar gjatë viteve të pasluftës. Ne jemi të orientuar nga Kosova. Mirëpo ne nuk do të lëshojmë pe ose t'i dëmtojmë të drejtat tona themelore, siç janë identiteti, tradita, kultura, religjioni, gjuha dhe të drejtat e barabarta për punësim. Në fushën e shfrytëzimit të gjuhës në institucione, mbetet edhe shumë për t'u bërë, në shkollat, në kuvende komunale, në proceset e hartimit të ligjeve, në gjykata dhe në institucione shëndetësore. Barra që e kanë komunitetet pakicë është e rëndë dhe për këtë ne duhet të tregojmë pjekuri, gjë të cilën edhe do ta bëjmë.

Si e shihni rolin tuaj si anëtar i Kryesisë së Kuvendit?

Përbrenda Kryesisë ne e kemi parimin e rotacionit për komunitetet e tjera. Boshnjakët, turqit dhe romët/egjiptianët e kanë mundësinë që të bëhen anëtarë të Kryesisë në bazë të këtij parimi. Dy të tretat e këtij mandati i takojnë grupit parlamentar 6+1. Unë do të jem në pjesën e parë dhe pas meje vjen Z. Mahir Yagcilar, kryetari i KDTP-së.

Të qenurit anëtar i Kryesisë është mjaft me rëndësi pasi që Kryesia është trup politik që udhëheq me çështjet politike të Kuvendit. Ajo e përcakton rendin e ditës dhe prioritetet gjatë përcaktimit të detyrave, ligjeve dhe çështjeve të tjera.

"Kontaktet rajonale parlamentare kanë rëndësi kruciale"

Me 10 dhjetor 2004, znj. Liljana Popovska bëri një vizitë në Kosovë për të marrë pjesë në programin përgatitor të ASI-it për deputetët e përbërjes së re të Kuvendit. Ajo deri para ca kohësh ishte zëvendëskryetare e Parlamentit të Republikës së Maqedonisë (FYROM). Me rastin e vizitës së saj në Kosovë ajo pati kënaqësin që të japë kontributin e saj, duke i bërë të njohura përvojat e saja për çështjet si dialogu rajonal dhe bashkëpunimi parlamentar.



A mendoni se bashkëpunimi ndërparlamentar mund të luajë një rol të rëndësishëm për të ndihmuar dhe lehtësuar integrimin rajonal? A kanë qenë programet e këtilla të dobishme për punën tuaj në Maqedoni?

S'ka pikë dyshimi se në këtë botë multi-kulturore është e natyrshme që të kemi një shkëmbim të këtyllë të përvojave, njohurive dhe vlerave kulturore. Madje, një gjë e tillë është edhe e domosdoshme në një botë të këtyllë multi-kulturore. Dihet se ne kemi mjaft gjëra të përbashkëta dhe së këndejmi kemi edhe probleme të përbashkëta. Por, çdo gjë përballohet më lehtë kur punojmë së bashku.

Maqedonia është e hapur ndaj çdo lloj bashkëpunimi, në të vërtetë ne kemi marrë rolin udhëheqës sa i takon bashkëpunimit rajonal. Kështu, bashkëpunimi ynë shtrihet në të gjitha nivelet – qeveriatar, parlamentar, etj.

Njëherësh, ne kemi zhvilluar iniciativat bilaterale dhe multilaterale në kuadër të bashkëpunimit rajonal. Një shembull i mirë është lobimi parlamentar për Korridorin 8. Kjo nismë u themelua në një mbledhje, që u mbajt në Ohër në qershor të vitit 2004, në të cilën morrën pjesë politikanë nga Turqia, Bullgaria, Shqipëria, Greqia, Italia dhe natyrisht Maqedonia. S'do mend se kjo është një nismë shumë e dobishme, ndaj

dhe është në interes të të gjithëve që të ketë sukses.

Një iniciativë tjetër është edhe karta e Adriatikut, e nënshkruar në maj të vitit 2003 nga krerët e qeverive të Kroacisë, Maqedonisë dhe Shqipërisë. Vlen të vihet në dukje se edhe parlamentarët janë përfshirë mjaft intezivisht në këtë nismë dhe se janë arritur rezultate mjaft konkrete në procesin e integrimin në NATO.

Ju keni qenë e angazhuar në organizatat e grave. A mendoni se programet rajonale mund të kontribuojnë në çështjet e grave?

Pa dyshim se aktivitetet rajonale mund të luajnë një rol shumë të rëndësishëm. Fjala vjen, unë punoj me Grupin punues për çështje gjinore të tavolinës së 1-rë të punës së Paktit të Stabilitetit – për demokratizim dhe të drejta njerëzore. Po kështu, ne kemi formuar edhe klubet parlamentare të grave. Kjo ua bënë të mundur grave politikane nga i gjithë rajoni që të tubohen dhe të diskutojnë për çështje nga më të ndyshmet.

Vlen të theksohet se gjatë pesë viteve të fundit, përfshirja e gruas në politikë dhe në vendim-marrje në rajon është ngritur nga 7 në 15%. Ndërsa, në Maqedoni është shënuar një rritje e trefishtë dhe tani pjesëmarrja e tyre është afro 18%.

Për dallim nga periudha parazgjedhore Kosova tani ka një opozitë mjaft të fuqishme. Cilat do të ishin këshillat tuaja për ate se si kjo opozitë do të mund të luante një rol konstruktiv në procesin legjislativ?

Unë nuk do të ipja ndonjë këshillë- secili e di për vete se si

është më mirë të veprohet. Por, pa dyshim se demokracia nuk mund të zhvillohet pa pasur një opozitë. Të gjitha partitë politike zhvillohen dhe përsosen me kalimin e kohës. Ato mësojnë që të jenë konstruktive si kur janë në opozitë ashtu edhe kur janë në qeveri. Partitë duhet të mësohen që jo vetëm të kritikojnë por edhe të ofrojnë dhe propozojnë zgjidhje. Fundja, qeveria dhe opozita krijojnë kornizën ligjore dhe atmosferën në vend.

A konsideroni se mund të mësohet diçka në Kosovë nga impenjimet e Maqedonisë për të siguruar përfaqësimin e grupeve të ndryshme etnike në sistemin politik?

Gjëja më e rëndësishme është që t'u përmbahemi dhe t'i respektojmë rregullat. Në Maqedoni ne kemi mësuar të jemi tolerant dhe të gjejmë zgjidhje përmes dialogut e jo përmes kërcënimeve apo mjeteve të tjera. Pa dyshim se ne nuk jemi ideal, por të paktën mendoj se gjërat janë duke ecur në drejtim të duhur.

Në këtë program përgatitor janë përfshirë organizata ndërkombëtare dhe vendore, OJQ dhe politikanë. A mendoni se ky lloj bashkëpunimi ka ndonjë përparësi?

S'do mend se ka mjaft avantazhe sa i takon mbështetjes së bashkëpunimit ndërmjet strukturave të ndryshme. Ndaj dhe është me rëndësi që të mos jemi të mbyllur ndaj asnjë sektori të shoqërisë, ngase kjo bën të mundur që të arrihen rezultate më të mira dhe efikasitet më i madh.

Intervistën e zhvilloi Gerët O'Brajën

Gjashtë qëllimet e NDI-së në përkrahjen e Kuvendit

"Buletini informativ i ASI-it" i bëri ca pyetje drejtorit të sapoardhur të NDI-së z. Tomas Bridle për pikëpamjet dhe projektet e tij.

Kohë më parë keni marrë postin e Drejtorit të programit të NDI-së për procese politike, që financohet nga USAID-i. A mund t'na thoni se cilat janë përshtypjet tuaja të para për atmosferën politikenë Kosovë dhe për Kuvendin?

Unë arrita pikërisht para zgjedhjeve për Kuvend, ndaj dhe pata rastin që jo vetëm ta ndjekim një pjesë të fushatës, por edhe t'i shikoj ca tubime dhe të takohem me disa liderë partiak. Kihej përshtypje se në përgjithësi u zhvillua një garë parazgjedhore mjaft e gjallë dhe energjike, ndërsa një pjesë e fushatës ishte mjaft profesionale. Programi ynë këtu, njëlloj si edhe programet e tjera të NDI-së në botë, ka për qëllim që të inkurajojnë dhe trajnojnë partitë politike që të zhvillojnë fushata të mirëfillëta, të cilat marrin parasysh pikëpamjet dhe shqetësimet e anëtarëve të partisë dhe votuesve, gjë e cila mendoj se deri diku është respektuar këtu. Njëherë, ishte mjaft inkurajues edhe fakti se dalja në zgjedhje ishte mjaft e madhe. Vlen të vihet në dukje se fushata GOTV (Dil dhe voto), që u drejtua nga një koalicion i grupeve civile, binte në sy ngado që udhëtova në Kosovë, dhe siç e dini ky program është mbështetur teknikisht nga NDI-ja, pëmes programeve të financuara nga USAID-i. Nga sa pashë në ditën e zgjedhjeve, votimet kaluan në mënyrë të qetë. Ndërsa, është më se e qartë se Kuvendi është duke u ballafaquar me një mori sfidash, mundësisht dhe ndryshimesh. S'do mend se ndryshimi më i madh është prezenca e opozitës në Kuvend, e cila parimisht mendoj se është një gjë mjaft e dobishme. Njëherit, ne shpresojmë se Qeveria do të jetë mjaft energjike në nxitjen

dhe mbështetjen e ideve dhe legjislacionit, që do të kërkojë reagim më të përgjegjshme nga Kuvendi.

Cilat janë objektivat tuaja sa i takon punës suaj me Kuvendin?

Një nga qëllimet të cilin do ta veçoja është bashkëpunimi aktual i organizatave ndërkombëtare përmes ASI-it. Pa dyshimi se ndihma duhet të koordinohet për të qenë e efektshme dhe ASI ka qenë një shumbull i këtij bashkëpunimi. Kjo seri e trajnimeve dhe seminareve për deputetët e ri të Kuvendit është një shembull dhe dëshmi e mirë e asaj se çfarë mund të arrijmë dhe sa efikas mund të jemi kur punojmë së bashku. Ndaj dhe shumë nga këto pikësnyime i konsideroj më parë si synime të ASI-it se sa si qëllime tona.

Objekti i dytë është përmirësimi dhe avansimi i rregullores së punës dhe i veprimtarisë së Kuvendit. Kjo nënkupton jo vetëm rregulla më të mira, por edhe respektim më konsekuent të atyre rregullave. Së këndejmi, ma merr mendja se ato duhet të jenë më të pranueshme për deputetët; pra të bëhen pjesë e punës së tyre të përditshme e jo të imponohen si struktura të huaja. Këto rregulla i sigurojnë opozitës të drejta, të cilat duhet të respektohen. Pos kësaj, si opozita ashtu edhe pozita kanë për obligim që jo vetëm të punojnë konform rregullave, por edhe të ndërtojnë një kulturë të traditës dhe tolerancës ndaj mendimeve të të tjerëve, të debateve të njëmendëta dhe të respektimit të idealeve demokratike, të cilat i përfaqëson institucioni.

Qëllimi i tretë do të ishte vazhdimi i fuqizimit të punës dhe rolit të komisioneve, të

cilat në të vërtetë janë bërthama e punë legjislative. Ky synim lidhet ngushtë me punën rreth rregullores së punës dhe me prezencën e një opozite aktive, e cila është e gatshme të luajë rolin e saj në procesin e ligjvënies.

Veç këtyre, edhe funksioni i mbikëqyrjes së ekzekutivit do të jetë më i theksuar gjatë këtij mandati, ngase deputetët dhe kryesuesit e komisioneve do të dëshirojnë që të monitorojnë jetësimin e ligjeve dhe aktivitetet dhe punën e secilës ministri, e në veçanti mënyrën se si ato i shpenzojnë paratë. Po kështu, këto çështje janë ngritur edhe nga shumë deputetë si gjatë diskutimeve ashtu edhe gjatë trajnimeve orientuese për deputetët e rinj. Sikundër edhe me rregulloren e punës, detyrat dhe qëllimet afatgjata të këtij funksioni nuk kanë të bëjnë vetëm me qartësimin e procedurave për procesin e mbikëqyrjes, por edhe me një bashkëpunim konstruktiv midis legjislativit dhe ekzekutivit, i cili ka një rëndësi të veçantë.

Pikësnyimi i katërt, kërret partiakë luajnë një rol të rëndësishëm në procesin legjislativ, ndaj dhe është po ashtu me rëndësi të sigurohemi që ato – si Qeveria ashtu edhe opozita – t'i kenë të qarta si procedurat e tyre të brendshme demokratike ashtu edhe strategjitë e tyre për shndërrimin dhe përfshirjen e ideve dhe platformave të tyre politike në agjendat e legjislativit

Njëherit, shpresoj se deputetët e këtij Kuvendi do të angazhohen aktivisht për të pasur marrëdhënie më të afërta me qytetarë dhe me votues, ndërsa ne do të bëjmë përpjekje që t'u ndihojmë në këtë drejtim.

Kështu, legjislativi dhe Qeveria së shpejti do t'i hapin gjashtë zyre për marrëdhënie me votuesit në Prishtinë dhe në komuna të tjera, në të cilët do të punësohet nga një nëpunës për secilën zyre dhe unë kujtoj se kjo ka një rëndësi të veçantë për Kuvendin.

Objekti i gjashtë dhe i fundit, unë shpresoj se ky Kuvend jo vetëm që do të jetë më i përgjegjshëm ndaj votuesve, por edhe ndaj shoqërisë civile. Pos kësaj, programi ynë civil ka angazhuar grupe të ndryshme vendore për të monitoruar edhe punën e kuvendeve komunale, gjë të cilën ka nga kuvendet komunale fillimisht e kanë parë me një lloj dyshimi – kush janë këta njerëz, të cilëve ju intereson puna jonë dhe e komentojnë punën tonë – por që në të vërtetë kjo është dëshmuar si një punë shumë e dobishme jo vetëm për kuvendet por edhe për shoqërinë civile.

Çfarë do të ndërmerrni ju për arritjen e këtyre synimeve?

Unë kujtoj që këto qëllime nuk dallojnë aq tepër nga ajo që ne tok me partnerët tanë të ASI-it tanimë jeni duke u përpjekur t'i përmbushim. Ma merr mendja se ne duhet të jemi të vetëdijshëm për ate se ekzistimi i opozitës do ta ndryshojë kontekstin në të cilin do të punojmë, por njëherit duhet të jemi koshient edhe për faktin se tani jemi duke punuar me deputetë, të cilët kanë një përvojë pune në këtë institucion dhe madje disa nga ta janë tanimë ministra të formuar. S'do mend se kjo e ndryshon kontekstin e punës jo vetëm për NDI-në por edhe për të gjitha organizatat tjera ndërkombëtare. Mirëpo, mjetet kryesore për punën me legjislativin mbeten të njëjta. Ndaj dhe



Tomas Bridle

Pet Kedëll, Drejtori i programit tonë për fuqizimin e legjislacionit dhe Edmond Efendija do ta vazhdojnë punën e tyre të shkëlqyeshme në Kuvend. Me këtë rast, vlen të vihet në dukje se gjatë viteve të shkuara ne i kemi angazhuar mjaft shpesh edhe dy konsulentë, Kevin Deveuksin and Sheri Vulfin. Por, Kevini sivjet ka qenë këtu një herë, si pjesëmarrës në programin përgatitor për deputetët e ri dhe shpresoj që së shpejti do ta takojmë sërish. Ndërsa, Sheri tani është duke punuar si eksperte për parti politike në USAID në Washington, ndaj dhe nuk do të jetë më me ne, por shpresoj që ajo do të vijë t'na vizitojë, që të paktën t'i shohë rezultatet e punës së saj të mëparshme.

Programi të cilin është duke e menaxhuar NDI-ja merret edhe me kuvendet komunale.

Po. Pet Kedëll është duke e menaxhuar atë program, me ndihën e Arben Kelmendit. Në të vërtetë ky program është mjaft i ngjashëm me punën që e bëjmë ne në nivelin qendror: kështu, ne punojmë me ta për të përmirësuar, avansuar dhe zbatuar rregulloren e punës, punën e komisioneve, mbajtjen

e seancave dëgjimore dhe për afrimin me votuesit. Dhe pos kësaj, ne kemi një bashkëpunim të ngushtë edhe me grupet qytetare, të cilat e monitorojnë punën e këtyre kuvendeve.

Vitin e kaluar, projekti juaj ka bashkëpunuar me një koalicion të grupeve civile rreth një fushate për reformimin e sistemit elektoral. Çfarë mendoni për këtë fushatë? A ka pasur ndonjë efekt afatgjatë?

Kjo ndodhi para se unë ta marrja postin e drejtorit, por me sa duket ka arritur disa rezultate të shënuara. Së pari, e ka ngritur vetëdijen e opinionit për ligjin elektoral. Janë të pakta ato vende ku publiku është aq aktivisht i angazhuar në këso lloj debatesh. Së dyti, ua bëri të mundur qytetarëve që të vetëdijësohen për ate se si të kenë më tepër kontroll mbi ardhmërinë e tyre, jo vetëm duke ushtruar ndikim tek ata që e kanë pushtetin, por edhe në mënyrën se si ata zgjedhen. Unë kujtoj se kjo ka një rëndësi të veçantë për një sistem politik, që është në zhvillim e sipër, si ky në Kosovë. Së treti, arriti ta bashkojë një koalicion të rrallë të grupeve civile dhe unë pres që këto grupe ta vazhdojnë bashkëpunimin.

Çfarë mendoni për organizimin e një fushatë tjetër për reformimin e sistemit zgjedhor?

Fushata e parë ka qenë mjaft e fuqishme- të shprehem pak më thjeshtë- një përvojë për grupet dhe personat që kanë qenë të përfshirë. Unë mendoj se shumë grupe civile dhe qytetarë do të vazhdojë të pyesin se a janë deputetët e Kuvendit përgjegjës ndaj atyre që i kanë zgjedhur dhe të cilët duhet t'i përfaqësojnë, apo ndaj liderëve të tyre partiakë, të cilët i kanë futur në lista. Unë nuk kam ndonjë përgjigje në këtë pyetje, por jam i bindur se kjo është një çështje me rëndësi, e cila duhet të ngritet nga grupet civile dhe kujtoj që vetë fakti se një çështje e këtillë është ngritur është shenjë e një pjekurie dhe zhvillimi në jetën politike dhe shoqërore të Kosovës.

A është kjo hera e parë që punoni për NDI-në?

Jo. Unë kam filluar të punoj në NDI qysh në prill të vitit 2002, së pari në Rusi, ku kam drejtuar programet rajonale për punë me partitë politike dhe më pas kam qenë Drejtor vendor i NDI-së për Kazakistan. Para kësaj kam punuar në Senat dhe në Dhomën e Përfaqësuesve

të Kongresit, si dhe në disa fushata për Kongres, Senat dhe në një fushatë presidenciale. Meqë familja ime është nga Çekia, unë kam pasur rastin të punoj edhe në Pragë dhe Bratisllavë për pesë vite, në fillim të viteve të 90-ta, fillimisht në zyrën e Presidentit Havell, e më vonë për një kontraktor të USAID-it, dhe së fundi edhe në sektorin privat.

A kanë ngjashmëri programet e NDI-së në Kazakistan me ato në Kosovë?

Po dhe jo. Konteksti politik atje është shumë i ndryshëm, ku një President mjaft i fuqishëm është duke u përballur me një opozitë gjithnjë e më aktive dhe më të zëshme. Kështu, ne kemi punuar si me Qeverinë ashtu edhe me partitë opozitare, duke zhvilluar trajnime dhe seminare për çështjet, njëlloj si edhe këtu në Kosovë, si: demokracia brenda partisë, organizimi i strukturave profesionale dhe efikase partiake, hartimi i platformave të mirëfillëta dhe porosive, e të tjera. Njëherit, ne kemi një bashkëpunim të ngushtë me dy grupe civile, Monitoruesit e pavararur të rrjetit të republikanëve, grup ky i cili siç dihet i monitoron zgjedhjet vendore dhe Shërbimin informativ të rinisë së Kazakistanit, që angazhohet për shtimin e përfshirjes së rinisë në proceset politike. Vlen të vihet në dukje se atje askurrë nuk kemi pasur një program zyrtar për Parlamentin, pjesërisht edhe për shkak se në të vërtetë Parlamenti i këtij vendi është shumë i afërt me Qeverinë. Kështu, në përbërjen e kaluar të Parlamentit vetëm pesë apo gjashtë nga 77 deputetë janë konsideruar si opozitarë; ndërkaq, në përbërjen e re të Parlamentit është vetëm një opozitar. Mirëpo, ne kemi punuar mjaft me fraksionet e partive në kuvendet dhe parlamentet komunale.

Mirëserdhët në Kosovë.

"Ne ende nuk i zbatojmë kompetencat që i kemi"

Intervistë me Gazmend Muhaxherin, anëtar i kryesisë së Kuvendit nga Lista Qytetare "ORA"

Është hera e parë që Kuvendi i Kosovës ka pozitë dhe opozitë. Cili do të jetë roli i ORA-ës në përbërjen e re të Kuvendit?

Ne do të jemi një opozitë konstruktive. Do të përpiqemi që të punojmë në përputhje me Rregulloren e Punës së Kuvendit. Dhe ndonëse jemi të gatshëm për të bashkëpunuar me shumicën, ne megjithatë gjithnjë do të jemi si vëzhgues ashtu edhe kritikues të qëndrimeve të partive në pushtet.

Çka mendoni për koalicionin? A mendoni se një një koalicion më i gjerë qeverisës do të ishte më i pranueshëm, duke e pasur parasysht rëndësinë që ka viti 2005?

S'do mend se koalicioni është rezultat i zgjedhjeve. Partitë politike që formuan koalicionin i kanë bërë llogaritë e tyre. Ndaj dhe mendoj se është e drejtë e tyre që ta bëjnë këtë koalicion. Koha do të tregojë nëse ky koalicion do të jetë i sukseshëm. Kjo nuk do të thotë se një koalicion më i gjerë do të ishte më i sukseshëm. Kemi parë edhe punën e një koalicioni më të gjerë në të shkuarën. Ne jemi koshient për rëndësinë që ka viti 2005 për Kosovën. Ne kujtojmë që opozita duhet të përfshihet në bisedime.

Sesionet plenare tani mbahen çdo muaj dhe jo çdo javë si më parë. A mendoni se ka gjasa që ky vendim të rishikohet dhe sesionet të mbahen më rregullisht e jo vetëm një herë në muaj?

Kjo do të varet nga partitë në pushtet. Unë kujtoj se sa më shumë sesione të kemi aq më produktivë do të jemi. Kryetari i Kuvendit, z. Daci vuri në dukje sot se ai do të impenjohet për të siguruar një veprimtari më të gjerë, ngase Kuvendi gjatë vitit



Gazmend Muhaxheri

të parë të mandatit të parë, nxorri vetëm gjashtë ligje. Pastaj, gjatë dy viteve të tjera ata miratuan shumë më tepër ligje, por megjithatë Kosovës i nevojiten ende ligje, ndaj dhe Kuvendi duhet të mbajë sesione më shpesh për t'i miratuar këto ligje. Së këndejmi, unë jam për ate që Kuvendi të mblidhet më dendur.

Në ç'mënyrë Kuvendi do ta vëzhgojë përmbushjen e standardeve?

Mënyra e vetme për ta përcjellur dhe vëzhguar përmbushjen e standardeve nga Qeveria, gjë e cila na mundësohet me Kornizë Kushtetuese dhe me rregullore të caktuara, është që ta ftojmë sa më shpesh që është e mundur Qeverinë dhe ministrin; për të raportuar në Kuvend lidhur me aktivitetin e tyre për arritjen e standardeve. Si forcë politike opozitare, ne me vendosmëri dhe përkushtim do t'i vëzhgojmë me kujdes punën

e ministrive dhe të Qeverisë në përgjithësi.

A do të preferoni që të mbaheshin sesione të veçanta për Standardet?

Unë nuk mendoj se duhet të mbahen sesione të veçanta për Standardet. Ministrinë i kanë të qarta detyrat dhe obligimet e tyre sa i përket standardeve, ndaj dhe duhet t'i përmbushin ato. Mirëpo, nëse ka ngecje dhe pengesa në përmbushjen e tyre, atëherë ato ngecje duhet të shmangen. Së këndejmi, sukcesi në përmbushjen e standardeve varet shumë nga ajo se sa do të impenjohen Qeveria dhe ministrinë në përmbushjen e tyre.

Çfarë mendoni ju për bashkëpunimin me UNMIK-un?

Unë besoj që problemi është se ne ankohemi për mungesë kompetencash, ndërsa nuk i zbatojmë as ato që i kemi. Prandaj, Kuvendi

duhet të punojë më tepër në mënyrë që t'u paraprijë proceseve dhe jo t'i ndëjkë ato. Vetëm koha do të tregojë se a do t'ia dalë mbanë Kuvendi që t'i realizojë ato. S'ka pikë dyshimi se ne duhet ta vazhdojmë bashkëpunimin me UNMIK-un në mënyrë që t'i zgjidhim problemet, nëse ka mundësi edhe për t'i miratuar amendamentet e propozuara në Kornizën Kushtetuese dhe pastaj të vazhdojmë edhe me zgjidhjen e problemeve të tjera.

Si do të kontribuoni ju si anëtar i kryesisë së Kuvendit në përmirësimin e cilësisë së punës së komisioneve?

Sot përmes një vendimi të veçantë është vendosur që anëtarët e kryesisë së Kuvendit nuk mund të jenë anëtarë të komisioneve, por mund të marrin pjesë në komisione vetëm si vëzhgues. Unë personalisht jam i interesuar që të bashkëpunoj me Komisionin për planifikim hapësinor, i cili është bashkuar me Komisionin për bujqësi. Mbase në këtë mënyrë do të arrihet një punë më efikase në miratimin e më tepër ligjeve nga kjo fushë.

Përshtypjet tuaja pas takimit të parë të kryesisë së Kuvendit?

Për mua, kjo ishte një përvojë e re, ngase ishte hera e parë që mora pjesë në këto mbledhje. Është më se e qartë se qëndrimet e partive në pushtet dhe opozitës shpeshherë do të jenë të ndryshme. Shpresoj që Kryetari i Kuvendit, prof. Daci, do të jetë konstruktiv dhe do ta respektojë mendimin e opozitës. Koha do të tregojë nëse ai është i gatshëm për një gjë të këtillë.

Intervistën e zhvilloi- Meolyde Salihu

Roli i qeverisë dhe opozitës në demokracinë parlamentare

Nga Jill Adler, Drejtoreshë, East-West Parliamentary Practice Project, email: jadler@ewppp.org

Projekti i Praktikës Parlamentare Lindje – Perëndim (East-West Parliamentary Practice Project - EWPPP), në kuadër të programit Aspektet dhe teknikat e demokracisë parlamentare: programi për përkrahje Kuvendit të Kosovës, organizoi të tretin në vazhden e pesë seminareve ndërparlamentare më 11 dhjetor 2004 në Prishtinë. Seminari, i cili ishte organizuar në bashkëpunim me Iniciativën për përkrahje të Kuvendit (ASI) të Misionit të OSBE-së në Kosovë, u përqendrua në rolet përkatëse të shumicës dhe opozitës në demokracinë parlamentare, formimin e koalicioneve dhe vazhdimësinë. Pjesëmarrës nga Kosova ishin Kryetari i Kuvendit të Kosovës, profesori Nexhat Daci, personeli nga kabineti i tij, anëtarët e Kryesisë së Kuvendit, kryesuesit e grupeve parlamentare, anëtarët e Parlamentit nga LDK-ja, AAK-ja, PDK-ja, ORA, dhe PDKSH-ja, dhe përfaqësuesit e minoriteteve jo-serbe në Kosovë (egjiptian, boshnjak, dhe turq). Gjithashtu morrën pjesë edhe dy ministrat e sapoemëruar, Sadik Idrizi dhe Bujar Dugolli.

Në mesin e pjesëmarrësve nga jashtë ishin ish kongresmeni nga SHBA-të David Skaggs; Petra Blass, ish nënkryetare e Bundestagut dhe Këshillëtare e lartë në Paktin e Stabilitetit për bashkëpunimin parlamentar; Malcolm Bruce, anëtar i dhomës së ultë, Mbretëria e Bashkuar; Fatmir Mediu, anëtar i Parlamentit të Shqipërisë; Bert Koenders, anëtar i Parlamentit, Holandë; dhe Zoran Shapuric, anëtar i Parlamentit të Maqedonisë.

Kryetari i Kuvendit, profesor Daci, u uroi mirëseardhje pjesëmarrësve të seminarit dhe e falënderoi EWPPP-në për përkrahjen Kuvendit të Kosovës. Ai theksoi se Kosova është duke u ballafaquar me sfida të mëdha, dhe me qëllim që të lëvizet para, institucionet e Kosovës duhet t'i përcaktojnë strategjitë e tyre prioritare. Vërejtjet hyrëse në emër të partive në qeveri i dhanë Fatmir Sejdiu (LDK) dhe Gjylnaze Sylja (AAK). Pikëpamjet e partive opozitare u paraqitën nga Jakup Krasniqi (PDK) dhe Teuta Sahatqija (ORA).

Znj. Sylja theksoi se koalicioni qeveritar më tepër dëshiron që të jetë përfshirës se sa përjashtues – grupi i AAK-së tanimë është pajtuar që të themelojë rregulloren e vet të punës – dhe do të përqendrohet në promovimin e projektligjeve të propozuara nga qeveria që do të merren me standardet/statusin, forcimin e institucioneve të Kosovës, infrastrukturën, administratën publike dhe arsimin. Z. Sejdiu nga LDK-ja foli për rëndësinë e temës së diskutuar. Ai theksoi se shumica dhe opozita duhet të tentojnë që të arrijnë konsensusin për çështjet madhore, dhe se që të gjitha palët duhet ta vlerësojnë punën e bërë nga komisionet parlamentare. Ai më tutje theksoi se parlamenti duhet ta forcojë rolin e vet mbikëqyrës gjatë katër viteve të ardhshme. Z. Sejdiu e përmbylli fjalën e tij duke shtuar se edhe LDK-ja, gjithashtu, do të jetë kritike ndaj qeverisë. Ai tha se demokracia i jep jo vetëm të drejtat, por edhe përgjegjësitë.

Zoran Shapuric, anëtar i par-

tisë qeverisëse në Parlamentin e Maqedonisë, theksoi se në demokracinë e reja, ku ndryshimet madhore kushtetuese janë normë, është thelbësore që qeveria dhe opozita të bashkëpunojnë. Fatmir Mediu, anëtar i opozitës në Parlamentin e Shqipërisë, tha se çështjet si harmonizimi i legjislacionit me standardet europiane duhet ta inkurajojnë qeverinë dhe opozitën që të punojnë së bashku drejt qëllimit të përbashkët. Ai më tutje e theksoi rëndësinë e detyrës ligjvënëse të deputetëve mbi të gjitha, dhe rolin kritik të opozitës në sigurimin e transparencës dhe kontrollimin e “tiranisë së shumicës.”

Hydajet Hyseni i partisë opozitare PDK vërejtë se përderisa të gjithë flasin për vlerën e opozitës, që të gjithë kërkojnë që të jenë pjesë e koalicionit qeveritar. Ai sugjeroi që për shkak të rrethanave specifike të jetës politike në Kosovë, në këtë kohë nuk mund të ketë pozitë/opozitë të mirëfilltë. Ai shtoi se me qëllim që të ketë marrëdhënie konstruktive midis shumicës dhe opozitës, duhet të përmirësohen marrëdhëniet midis Kryetarit të Kuvendit, Kryesisë dhe Komisioneve.

Sadik Idrizi i koalicionit VAKAT theksoi se minoritetet jo-serbe në Kosovë dë të dëshironin të kyçeshin në të gjitha proceset politike.

Profesor Daci ua tërhoqi vëmendjen pjesëmarrësve lidhur me keqpërdorimin e autoritetit, dhe e theksoi nevojën për të balancuar stabilitetin dhe efikasitetin. Sipas tij, koalicioni qeverisës aktual do të jetë më i suksesshëm

se sa ai i mëparshmi, pasi që në mandatin e kaluar efikasiteti ishte sakrifikuar në favor të stabilitetit. Ai shtoi se kryesimi me komisione do të jetë proporcional me numrin e vendeve në Kuvend, me ç'rast do të përfitojë opozita. Ai e shprehu besimin se Kosova do të jetë në gjendje që ta arrijë pavarësinë normale duke i përbushur standardet e përcaktuara nga bashkësia ndërkombëtare.

David Skaggs, Drejtor i Qendrës për demokraci dhe qytetari në Washington D.C., tha se edukimi qytetar është duke fituar gjithnjë e më tepër rëndësi në Shtetet e Bashkuara, dhe e theksoi rëndësinë e vetëdijësisë të një pjesë e të rinjve mbi detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në shoqëri demokratike. Malcolm Bruce, deputet nga Mbretëria e Bashkuar, foli mbi rolin qenësor të “opozitës lojale” në kritikimin e qeverisë, dhe mbi masat e instrumentet praktike që i ka në dispozicion opozita për ta forcuar funksionin e vet të kontrollit. Enver Hoxhaj nga PDK shtoi se opozita tani po përpqet që ta përcaktojë se çfarë instrumente të shfrytëzojë me qëllim që të ketë ndikim në politikat e qeverisë.

Programi i EWPPP-së në përkrahje të Kuvendit të Kosovës do të vazhdojë gjatë vitit 2005. aktivitetet do të përfshijnë një vizitë pune të anëtarëve të Kuvendit të Kosovës në një parlament të regjionit, në dimër/pranverë, si dhe një seminar në Prishtinë gjatë muajit maj. EWPPP do ta vazhdojë bashkëpunimin e vet të ngushtë me Iniciativën për Përkrahje të Kuvendit (ASI).

Raporti mbi zbatimin e ligjeve të Kuvendit zbulon mangësitë në përgatitjen e akteve plotësuese

Michael Schuetz, Kryesues i Seksionit për sundim të ligjit, Misioni i OSBE-së në Kosovë.

Tanimë sfida kryesore për Kosovën është bërë formimi i institucioneve demokratike dhe krijimi i shoqërisë shumetnike e cila do të qeverisëj nga sundimi i ligjit. Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK-u) dhe Institucionet e Përkohshme të Vetë-qeverisjes (IPVQ-të), kanë arritur rezultate të konsiderueshme në krijimin e kornizës ligjore të domosdoshme për përmbushjen e këtij qëllimi me miratimin e rregulloreve dhe ligjeve të shumëta. Nevoja për hartimin e ligjeve të reja është theksuar në mënyrë të vazhdueshme nga përfaqësuesit e administratës ndërkombëtare dhe opinionin publik i Kosovës, me qëllim të tejkalimit të zbrastësive ekzistuese në mes të sistemit të trashëguar ligjor të Jugosllavisë dhe realitetëve të reja sociale, ekonomike dhe politike. Një pjesë e madhe e resurseve të administratës ndërkombëtare dhe IPVQ-të u janë përkushtuar arritjes së këtij pikësnyimi, ndërsa rezultatet e këtyre aktiviteteve në masën më të madhe mund të konsiderohen si pozitive.

Në të njëjtën kohë, koncepti i qeverisjes së mirë karakterizohet jo vetëm nga miratimi i akteve të domosdoshme ligjore por edhe nga zbatimi i duhur i këtyre rregulloreve. Zbatimi i kornizës së re ligjore në Kosovë, me arsye, nuk ka qenë në fokus të administratës ndërkombëtare dhe IPVQ-ve për shkak të prioriteteve të tjera. Megjithatë, procesi i vazhdueshëm i bartjes së kompetencave nga UNMIK-u tek IPVQ-të, është një arsye shtesë për bashkësinë ndërkombëtare që të kërkojë përgjegjësi më të madhe nga IPVQ-të. Një formë e përgjegjësisë mund të

jetë implementimi i legjislacionit nga IPVQ-të në kuadër të kompetencave të tyre.

Raporti i fundit "Zbatimi i ligjeve të Kuvendit të Kosovës nga dega ekzekutive e IPVQ-ve" është vëzhgimi i parë i tillë i bërë nga Departamenti i të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit i OSBE-së, përmes seksionit të vet të sundimit të ligjit. Qëllimi parësor i raportit është që të përcaktohet se në çfarë mase zbatohen në mënyrë të rregullt ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës me miratimin e legjislacionit plotësues.

Legjislacioni plotësues ka të njëjtin efekt dhe autoritet sikur të ishte pjesë e aktit (amë), d.m.th. ka fuqi ligjore. Është mjet përmes të cilit ekspertët në subjektin e mbuluar me ligj mund ta formulojnë një sërë masash autoritative të cilat e mundësojnë zbatimin praktik të aktit amë. Kjo bëhet pa pasur nevojë që Kuvendi t'i shqyrtojë detajet e çështjeve teknike për të cilat ndoshta nuk ka ndonjë përvojë specifike. Së këndejmi, Kuvendi nuk mund të parashikojë çdo eventualitet që duhet të mbulohet nga legjislacioni kur miratohet fillimisht. Nëse konsiderohet se autoriteti i dhënë me aktin amë është i pamjaftueshëm, atëherë legjislacioni plotësues mund të merret me problemet, zbrastësitë ose domosdoshmërinë për informata të aktualizuara kur ato paraqiten, duke i adresuar ato në kategori të përkufizuara hierarkike të akteve plotësuese.

Vlerësimi i përgjithshëm i Seksionit të sundimit të ligjit do të thotë se procesi i hartimit dhe miratimit të akteve plotësuese nga dega ekzekutive e IPVQ-ve ka filluar me një vonesë të konsiderueshme, pas të cilës shumë institucione ia kanë arritur që

gradualisht t'i tejkalojnë vështrësitetë fillestare dhe aktualisht janë duke arritur suksese të konsiderueshme në procesin e implementimit. Në të njëjtën kohë, shumica e ministrive nuk kanë pasur mundësi të balancuara me afatet kohore të përcaktuara për miratimin e legjislacionit plotësues. Njëra ndër arsytet për këtë është prioriteti i dhënë nga ministrinë për përgatitjen e projektligjeve të reja përbrenda fushëveprimit të tyre përkatës që duhet t'i dorëzoheshin Kuvendit; një tjetër është mungesa e resurseve të mjaftueshme në zyrat ligjore. Procesi i themelimit të institucioneve i paraparë me ligjet e miratuara ka filluar me sukses. Këto institucione si Inspektorati sanitar, Agjencia Kadastrale e Kosovës, dhe Agjencia Pyjore e Kosovës, duhet të përpiqen që të arrijnë praktika të njëjta në zbatimin e ligjeve përkatëse.

Raporti, megjithatë, zbulon mangësi të konsiderueshme në rregullimin ekzistues të akteve plotësuese dhe në praktikën e nxjerrjes së tyre. Mangësitë kryesore përfshijnë mungesën e përkufizimit ligjor të llojeve të akteve plotësuese të nxjerra nga qeveria; shfrytëzimin e terminologjisë kontradiktore për aktet plotësuese në ligjet e Kuvendit; shmangien nga kategoritë e përcaktuara ligjorisht dhe nxjerrjen e llojeve të tjera të akteve plotësuese; përkufizimin e pamjaftueshëm të caqeve të marrëdhënieve shoqërore të rregulluara me çdo akt plotësues; sikurse edhe dështimin për botimin e akteve plotësuese.

Raporti rekomandon, pikësepari, konsolidimin e përgjegjësisë për degën ekzekutive të IPVQ-ve. Kjo mund të arrihet përmes themelimit të

një mekanizmi mbikëqyrës për implementimin e ligjeve të Kuvendit të Kosovës në kuadrin e Zyrës së Kryeministrit. Mekanizmi mund ta ketë strukturën vijuese. Do të duhej të përcaktohen pikat e kontaktit në çdo institucion përbrenda degës ekzekutive. Pas miratimit të ligjit nga ana e Kuvendit të Kosovës, zyra ligjore e institucionit implementues do të duhej t'i identifikonte aktet plotësuese që duhet të nxjerren dhe ta përgatisë një orar/matricë për përmbushjen e kësaj detyre. Kjo informatë pastaj duhet t'i dorëzohet Zyres së Kryeministrit brenda një muaji prej datës kur ligji publikohet. Zyra ligjore e institucionit implementues duhet të përgatisë një raport tre-mujor për Zyrën e Kryeministrit mbi progresin e zbatimit të legjislacionit parësorë përbrenda fushës së aktiviteteve të veta përkatëse.

Raporti gjithashtu i rekomandon Kuvendit të Kosovës që ta shqyrtojë vendosjen e mbikëqyrjes periodike të parlamentit mbi aktivitetet e degës ekzekutive me qëllim të sigurimit të përgjegjësisë së shtuar të qeverisë në fushën e implemetimit të ligjeve të Kuvendit. Përveç kësaj, Zyra e Kryeministrit do të duhej të paraqiste së paku një raport vjetor Kuvendit për procesin e zbatimit të legjislacionit parësorë si pjesë e kësaj mbikëqyrjeje.

Prania e kategorive dhe përkufizimeve të ndryshme për aktet plotësuese në ligjet e ndryshme të Kuvendit të Kosovës shkakton konfuzion në hierarkinë dhe një-trajtshmërisë e tyre. Ekzistojnë disa shembuj kur Kuvendi i ka përkufizuar kategoritë e akteve plotësuese përbrenda

secilit ligj.² Kjo qasje, ndonëse e dobishme për implementimin e ligjeve individuale, krijon paqartësi ligjore gjatë zbatimit të tërësisë së ligjeve. Prandaj, raporti rekomandon që Qeveria më parë duhet ta hartojë, kurse Kuvendi pastaj ta miratojë Ligjin e Akteve Normative. Ligji do t'i përkufizonte llojet dhe hierarkinë e akteve normative në Kosovë, sferën e marrëdhënieve shoqërore që rregullohet me ta si dhe organet përgjegjëse për nxjerrjen e tyre. Miratimi i këtij ligji do të kontribuojë shumë në krijimin e qartësisë ligjore.

Zyrat ligjore në ministri ballafaqohen me shumë sfida. Aktualisht nuk është e pazakonshme që zyra ligjore me vetëm 3-5 nëpunës të përballohet me detyra që kërkojnë shumë më tepër aftësi e kapacitet. Në këtë aspekt, ndodh që aktet plotësuese në disa raste të hartohen madje edhe një vit pas kalimit të afatit të caktuar. Për këtë arsye, raporti rekomandon që para miratimit të ligjeve që kërkojnë përvojë të specializuar për implementimin e tyre, duhet të bëhet një studim i realizueshmërisë nga ana e zyrës ligjore përgjegjëse për ta përcaktuar se në çfarë mase institucionet në Kosovë janë në gjendje që të kontribuojnë në jetësimin e ligjeve të tilla. Zyrat ligjore në ministritë e ndryshme duhet të përfshijnë në veprimtarinë e tyre një qasje më të balancuar, ku implementimi i ligjeve, tanimë të plotfuqishme, do të ketë një prioritet të ngjashëm si hartimi i legjislationit të ri.

Në fund, bashkësia ndërkombëtare, përfshirë këtu organizatat humanitare, do të lipsej ta vazhdonin përkrahjen për IPVQ-të në përgatitjen e projektligjeve sipas nevojës. Megjithatë, ndihma e tillë nuk do të duhej të ndërpritet pas miratimit të ligjit nga Kuvendi i Kosovës, por duhet të vazhdojë edhe në fazën e implementimit. Një trajtim i këtillë do të siguronte zhvillimin e vazhdueshëm të sundimit të ligjit në Kosovë.

“Qeveria e Kosovës dhe opozita duhet të punojnë së bashku për statusin final.”

Me 10 dhjetor 2004, z. Fatmir Mediu bëri një vizitë në Kosovë, për të marrë pjesë në programin përgatitor për përbërjen e re të Kuvendit. Me këtë rast, si kryesues i Komisionit për Integrim në UE të Parlamentit të Shqipërisë, ai shprehu pikëpamjet e tij për dialogun rajonal dhe bashkëpunimin parlamentar.

Çfarë mendoni se mund të arrihet me nismat për bashkëpunim parlamentar?

Në sajë të përvojës sime, unë kujtoj se programet si ky në të cilin po marr pjesë sot, janë shumë të dobishme sa i takon shkëmbimit të përvojave, ngase më pas kur të kthehem në vendet tona, këto njohuri të reja mund t'i zbatojmë në veprimtarinë tonë.

S'do mend se, vendet e rajonit kanë arritur bashkëpunim me ritme të ndryshme me Bashkimin Evropian. Kështu, ka vende tanimë kanë arritur Marrëveshjen për Stabilizim dhe Asocim (SAAs), ndërsa ca të tjera janë ende në negociata për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Ndaj dhe mendoj se shkëmbimi i përvojave rreth këtij procesi dhe thellimi i bashkëpunimit për çështje të ndryshme në rajon është shumë me rëndësi. Unë takohem të paktën dy herë në vit me politikanët nga rajoni.

Çerçili me një rast pati thënë se “Ballkani prodhon më tepër histori se sa që mund të konsumojë”. Por, unë shpresoj se ne mund të qëndrojmë mbi historinë. Përmes punës sonë me organizatën e Praktikave Parlamentare të Lindjes dhe Perëndimit (EWPPP), ne së bashku mund të gjejmë një zgjidhje të përbashkët. Fjala vjen në Shqipëri, jemi vonuar me nëshkrimin e Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asocim (SAA), për shkak se nuk mund të mbajmë zgjedhje të lira dhe të drejta. Së këndejmi, këto takime na bëjnë të mundur që të mësojmë nga përvojat e të tjerëve dhe të përmirësohemi dhe përparojmë edhe në këtë aspekt.

Cilat do të jenë sfidat e opozitës në

Kosovë pas zgjedhjeve të fundit?

S'ka pikë dyshimi se kjo periudhë do të jetë mjaft sfiduese për opozitën. Në vendin tim unë jam në opozitë. Opozita ka dy role: në Parlament dhe në sferën e opinionit publik. Ndaj, është punë e vështirë, ngaqë për çështjet, si integrimi në Evropë dhe në NATO, është e domosdoshme arritja e një konsensusi midis Qeverisë dhe opozitës, por veç kësaj opozita duhet të sigurojë edhe që Qeveria ta kryejë punën e saj me korrektesë dhe në mënyrë transparente.

Në Kosovë, situata është pak më ndryshe. Qeveria dhe opozita duhet të punojnë së bashku për statusin final. Së këndejmi, politikanët duhet të përqëndrohen në çështje konkrete e jo në taktika. Debatet duhet të bazohen në politika.

Çfarë mund të bëjnë politikanët e Kosovës për të siguruar që Kuvendi të funksionojë në mënyrë efikase?

Kuvendi i Kosovës ka formuar një komision të ri për Bashkëpunim ndërkombëtar dhe integrim evropian. Ma merr mendja se këto dy çështje duhet të ndahen ndërmjet dy komisioneve, ngase ato dallojnë mjaft nga njëra tjetra.

Më vjen mirë që Kosova ka pasur zgjedhje të lira dhe të drejta. Arritja e një objekti të këtillë në Shqipëri përbën një shqetësim dhe sfidë mjaft të madhe. Kosovarët ia kanë dalur mbanë që të konstitujnë Kuvendin dhe institucionet. Ndërsa, tani është me rëndësi që të mos e mbështesin punën e tyre në taktika, por në politika. Ata duhet të impenjojnë seriozisht për përmbushjen e standardeve para statusit.

E gjithë shoqëria kosovare duhet t'i respektojë institucionet të formuara nga bashkësia ndërkombëtare dhe t'i merr parasysht këshillat e UE-së dhe ShBA-ve.

Ju jeni kryesues i Komisionit për integrim evropian në Parlamentin e Shqipërisë. Si është duke avansuar Shqipëria drejt integrimeve evropiane dhe çfarë problemesh kanë mbetur të pazgjidhura?

Në qershor të vitit 2005 ne do të kemi zgjedhje, të cilat duhet të jenë të lira dhe të drejta. Por, krimi i organizuar mbetet një ndër problemet dhe shqetësimet më të mëdha. Dihet se bandat kriminale kanë shumë para, ndaj dhe në të kaluarën atyre u ka shkuar ndoresh që të ndikojnë aq shumë në politikë sa që kanë arritur ta pengojnë luftën kundër kimit. Mirëpo, kohëve të fundit është shënuar një rritje e ndërgjegjësimit të shoqërisë për këtë çështje, ndaj dhe besoj se do të ketë përparime në luftën kundër kimit të organizuar.

Opozita është duke punuar për një të ardhme më të mirë. Unë kujtoj se Shqipëria ka një gjeneratë dhe popullatë të re, e cila është e interesuar për të punuar për një të ardhme më të ndritur. Ne kemi krijuar marrëdhënie të mira me Unionin Evropian. Ne marrim ndihma përmes programit CARDS dhe kemi takime me Komisionin Evropian çdo gjashtë javë. Ndërkaq, deputetët shqiptarë takohen rregullisht me Delegacionin e Evropës Juglindore të Parlamentit Evropian.

Intervistën e zhvilloi Garet O'Brajen

Bashkëpunimi parlamentarë në Berlin, Bruksel dhe Paris: Avansimi i punës profesionale në administratën e Kuvendi të Kosovës

nga Alfred Drescher, *Ekspert i lartë për burime humane dhe menaxhment të presonelit, email: alfred.drescher@t-online.de*

Profesor Heinrich Grose - Sender, *Ekspert i lartë për çështje të hartimit të reformave ligjore parlamentare, email:grosse-sender@t-online.de*

Programi i trajnimit për punonjësit e Kuvendit të Kosovës, i zbatuar me ndihmën e ekspertëve të tri parlamenteve evropiane, të cilët marrin pjesë në programin e AER-it "Mbështetja Kuvendit të Kosovës" si dhe vizitat studimore në Asambleenë Nationale në Paris, në Dhomën e Përfaqësuesve të Belgjikës si në Bruksel dhe në Bundestagun gjerman në Berlin, përbëjnë pjesën më të rëndësishme dhe njëherit janë edhe si shpërblim për mësimin aktiv për futjen dhe përdorimin e standardeve evropiane në administratat e parlamenteve. Ky program u implementua përmes ekspertëve të parlamenteve evropiane, që marrin pjesë në projektin e AER-it për "Mbështetje të Kuvendit të Kosovës".

Vlen të theksohet se për organizimin e këtyre vizitave studimore duhej bërë përgatitje të gjata, në veçanti duke pasur parasysh mënyrën se si mund të adresoheshin ato nevoja. Afro 130 punonjës u punësuan kryesisht pas periudhës së zgjedhjeve të para për Kuvendin e Kosovës, në pranverë të vitit 2002. Ndaj, vetëm pas kësaj periudhe ata filluan të fitojnë përvojë në punën e administratës së parlamentit të një vendi demokratik. Për këtë arsye fillimisht lipsej që të gjindej një zgjidhje, e cila do të merrte parasysh përvojën e tyre praktike fillestare në administratën e parlamenteve moderne. Projekti parashikonte formimin e grupeve punuese, të cilët jo vetëm që do të trajtonin çështje të caktuara profesionale dhe të bënë propozime (fjala vjen për rregulloret e punës, udhëzimet për punën e komisioneve,

statutin e personelit, udhëzimet e stafit), por do të bënë edhe vlerësimin e nevojave për ndërtim të kapaciteteve.

Ndërsa, nevojat për trajnim janë diskutuar tok me punonjësit e Kuvendit të Kosovës që morën pjesë në të dy grupet atë të "Reformës Ligjore- Parlamentare" (të kryesuar nga: profesor Heinrich Grose – Sender) dhe të "Personelit and Buxhetit" (të kryesuar nga: Alfred Drescher). Më pas, u zhvillua edhe një diskutim i gjerë rreth programit me udhëheqësin e ekipit, profesor Dr. Nikolas Maziau, me kryesuesin e administratës, Sekretarin e Përgjithshëm Isuf Demajn dhe me të dy drejtuesit e departamenteve, Daut Beqirin dhe Isa Nezirin.

Pas miratimit të programit gjithëpërfshirës për ndërtimin e kapaciteteve, Sekretari i Përgjithshëm propozoi që trajnimet të mbahen gjatë kohës së lirë të punonjësve- pra, gjatë vikendeve-, në mënyrë që trajnimet të mos pengojnë funksionimin e rregullt parlamentar të Kryesisë, sesioneve plenare dhe aktiviteteve të komisioneve të Kuvendit të Kosovës. Njëherësh, ai vuri në dukje se të gjithë punonjësit, të cilët ishin parashikuar që të marrin pjesë në programin për ndërtimin e kapaciteteve, janë të obliguar të marrin pjesë në sesionet e trajnimit. Veç kësaj, AER-ika kërkoi nga Ekipi i Projektit që të lejojë pjesëmarrjen në vizitat studimore të vetëm atyre punonjësve të Kuvendit, të cilët kanë treguar sukses në seminarin parapërgatitor.

Kështu që, programi gjithëpërfshirës për ndërtimin e kapaciteteve dhe trajnim, filloi vetëm

pas përgatitjeve rigoroze, por të domosdoshme organizative. Përgatitjet dhe udhëzimet për të gjitha programet e trajnimit u bënë për shkak të faktit se është detyrë e administratës së Kuvendit që të ndihmojë dhe lehtësojë punën e Kuvendit, komisioneve, nën-komisioneve dhe deputetëve. Pas vizitave të rregullta të Sekretarit të Përgjithshëm dhe pjesëmarrjes së të dy kryesuesve të departamenteve, ishte më se e qartë se qëllimi ynë kishte përkrahjen e plotë të udhëheqjes së administratës. Për këtë arsye kjo ngjarje pati edhe karakter mbikëqyrës për punonjësit e administratës.

Pilot seminari i parë (prej të premtës deri të dielën) me temën "Procedurat për zgjedhjen e stafit dhe planifikimi i karrierës në administratën e Kuvendit të Kosovës" u mbajt në sallën e konferencave të një hoteli, si seminar vikendi. Të gjithë pjesëmarrësit në seminar ishin punonjës të Kuvendit, drejtues të departamenteve të personelit dhe buxhetit. Kështu, pjesëmarrja e Departamentit për Buxhet kishte për qëllim që t'ua bëjë të mundur punonjësve të departamenteve që t'i thellojnë dhe zgjerojnë njohuritë e tyre. Është e udhës të thuhet se seminari u vlerësua si mjaft i sukseshëm. Ndaj dhe udhëheqja e administratës kërkoi nga drejtuesit e projektit që edhe në të ardhmen seminarin dhe ngjarjet e këtilla t'i organizojnë në njëjtën mënyrë.

Pos kësaj, u organizua edhe një seminar tjetër me temën "Përgatitja, miratimi, implementimi dhe kontrollimi i buxhetit të Kuvendit të Kosovës". Ky seminar kishte për qëllim thellimin

e njohurive mbi praktikat dhe transmetimin e njohurive elementare për punën e administratës në parlamentet evropiane.

Ndërsa aktivitetet rreth stafit dhe buxhetimit shërbejnë për përmirësimin dhe zgjerimin e strukturës së brendshme administrative, pra drejtëpërdrejt edhe të Kuvendit, masat në sferën e punës rreth Reformës Ligjore Parlamentare kishin për synim përmirësimin dhe zgjerimin indirekt të shërbimeve që ofrohen nga administrata për parlamentin, komisionet e tij dhe deputetët.

Meqë mënyra dhe koncepti i shërbimeve janë përcaktuar përmes përfituesve të sipërpërmendur, ishte e udhës që në intervistat për vlerësimin e nevojave të përfshiheshin si deputetët ashtu edhe komisionet.

Të gjitha propozimet për hartimin e përmbajtjes së trajnimit janë përgatitur në bashkëpunim me grupin punues të përbërë nga anëtarët e administratës dhe të kryesuesve të departamenteve. Miratimi do të arrihej më lehtë sikur të shfrytëzoheshin njohuritë ekzistuese dhe specifikat kosovare, të cilat u krijuan gjatë historisë dhe u përcaktuan dhe formësuan përmes kushteve të përgjithëshme politike në Kosovë.

Ndërkaq, seminarin "Bazat e punës parlamentare të Kuvendit të Kosovës; Përgatitja profesionale, implementimi dhe procedurat pas mbledhjeve plenare", "Detyrat e komisioneve të Kuvendit të Kosovës"; Përgatitja profesionale, implementimi dhe procedurat pas mbledhjeve plenare", dhe "Puna praktike legjislative në Kuvend dhe

harmonizimi me ligjet evropiane për juristët e Kuvendit të Kosovës“ janë mbajtur pikërisht bazuar në njohuritë dhe specifikat e lartpërmendura.

Ndër çështjet më të rëndësishme që u debatuan ishin: funksionet e Kuvendit, në veçanti funksioni legjislativ dhe i kontrollit; metodat e hartimit të legjislacionit dhe parakushtet për nxjerrjen e ligjeve të mira; rregullorja e punës; Zyra për parashtrësia dhe ankesa; përgatitja, implemetimi dhe procedurat pas mbledhjeve plenare dhe të komisioneve; puna rreth ligjeve me sinopsis (përmbledhje) (Tableau comparatif- Tabelë krahasimtare); shërbimi parlamentar për konsultime (mbledhja e informatave, këshilla për ligjet ose për çështje të caktuara sipas kërkesës dhe krahasimi i nismave parlamentare me standartet evropiane).

Në seminar janë përdorur metoda dhe mjete të zakonshme që përdoren për trajnimin e të rriturve. Prandaj, temat dhe çështjet e shtjelluara u zhvilluan në formë të debeteve dhe diskutimeve interaktive. Duhet theksuar se pjesëmarrësit përfshirë këtu edhe kolegët nga Dhoma e Përfaqësuesve të Belgjikës, Bundestagu gjerman dhe Asambleja Nationale e Francës, në mënyrë intensive kanë punuar në grupe dhe kanë bërë studime individuale të rastit. Kjo bëri të mundur që këto tema dhe çështje të trajtohen nga këndshikime të ndryshme, duke marrë parasysh historitë e vendeve të tjera dhe përvojat e llojllojshme dhe duke i krahasuar ato me shembujt dhe kushtet e përgjithëshme në Kosovë.

Përzgjedhja dhe trajtimi i temave nga ekspertët ndërkombëtarë, bënë që pjesëmarrësve jo vetëm t'u shtohet vullneti, por në të njëjtën kohë edhe t'u zgjohet kërshëria për të mësuar më tepër për funksionimin e përditshëm të parlamenteve të Belgjikës, Gjermanisë dhe Francës, pas së ashtuquajturës “përvojë



Sekretari i Kuvendit, Z. Isuf Demaj, dhe personeli i Departamentit ligjor kohë më parë vizituan Assemblée Nationale në Paris

laboratorike“ në grupet punuese, takime të punës dhe seminare.

Udhëtimet studimore në tri parlamentet evropiane u përgatitën me shumë kujdes, ato u harmonizuan me punën që ishte bërë dhe u vënë në jetë me një përkushtim dhe angazhim të lartë nga ana e parlamenteve mikëpritëse. Vlen të theksohet se sekretarët e përgjithshëm të parlamenteve mikëpritëse e shfrytëzuan këtë rast që t'u ndihmojnë personalisht kolegëve kosovarë. Kështu që, përmes kësaj, u vendosën marrëdhënie personale- kolegjiale, të cilat kanë rëndësi jashtëzakonisht të madhe për bashkëpunim të parlamenteve në të ardhmen. Gjatë diskutimeve mbi vlerësimin me pjesëmarrësit, u konstatuan dy gjëra: kontakti i drejtpërdrejt jo vetëm që ndikoi në thellimin e njohurive teorike, por dëshmoi edhe për punën praktike, efikasitetin dhe aftësinë për t'u përballur me punën e përditëshme të parlamentit.

Aspekti i dytë ishte mjaft befasues, por jo edhe më pak i rëndësishëm: Ishte e qartë se gjatë këtyre vizitave studimore u forcuan si vetëdijsimi ashtu edhe vetëbesimi i pjesëmarrësve. Nga aspekti praktik, mund të thuhet se u konfirmua nevoja për ndryshime të nevojshme dhe gjetjen e zgjidhjeve, si dhe për “shndërrimin” e njohurive teorike në eksperinecë praktike, të cilat mund të jenë të dobishme gjatë kryerjes së obligimeve të tyre të përditshme.

Për dy grupet profesionale, u zhvilluan programe të veçanta. Kështu, në fushën e teknologjisë informative (IT), u organizuan dy seminare gjatë vikendit me ekspertët e teknologjisë informative të parlamenteve të Belgjikës dhe Francës. Këta punonjës, sipas të gjitha gjasave do të kenë rastin që jo vetëm t'i shohin pajisjet dhe mbështetjen teknike të parlamentit të Belgjikës, por edhe t'i takojnë anëtarët e komisioneve dhe deputetët e këtij parlamenti.

Pos kësaj, u organizua edhe një program tjetër special për punën me protokoll. Të dy punonjësit u njoftuan me punën e tyre teorike, duke u mbështetur në përvojën evropiane. Ndërsa, pas pjesës teorike, ata patën rastin që të njihen edhe me punën praktike të Bundestagut gjerman dhe të Asamblesë Nationale të Francës.

Ndërkohë, janë planifikuar edhe seminare të tjera për muajin janar dhe shkurt 2005, me qëllim të thellimit dhe përforsimit të njohurive të fituara. Këto seminare do të organizohen për departamentet për çështje ligjore, staf dhe buxhet dhe për fushën e prokurimit. Ndërsa, një seminar i veçantë, që do të organizohet për kryesuesit e njësive organizative, do të merret me menaxhmentin e stafit dhe bashkëpunimin me administratën.

Të gjitha shpenzimet për ndërtimin e kapaciteteve, përfshirë vizitat studimore, u mbuluan nga projekti i AER-it: „Mbështetje

Kuvendit të Kosovës“. Ndërsa, shpenzimet për vizitat tjera studimore u mbuluan nga parlamentet mikëpritëse dhe nga Kuvendi i Kosovës.

Marrë në përgjithësi, mund të thuhet se administrata e Kuvendit ka shënuar një progres të madh gjatë një viti. Së këndejmi, kjo administratë ka parakushte të mira për t'i ofruar shërbime përbërës së re të Kuvendit -madje, për të shërbyer edhe sipas standardeve ndërkombëtare – dhe për të qenë një shërbim i mirëfillët për parlamentin, komisionet e tij dhe deputetët.

Projekt po kështu u ka ofruar edhe mbështetje profesionale deputetëve, në fillim të mandatit të ri. Kështu, tok me OSBE-në dhe ASI-in ne i ftuam deputetët e Kuvendit që të marrin pjesë në të dy seminarët. Mund të thuhet se deputetët treguan një interesim të shtuar për të dy seminarët (“Seminarin për deputetët e ri të Kuvendit të Kosovës” dhe për “Institucionet e UE-së dhe acquis communautaire për deputetët”). Njëherësh, diskutimet aktive të deputetëve kosovar me homologët e tyre nga Franca dhe Belgjika si dhe me ligjëruesit, dëshmuar edhe për interesimin e deputetëve për përvojat e parlamenteve evropiane. Pos kësaj, edhe mediat – stacionet televizive, radiot dhe gazetate- dhanë raporte mjaft eksplicite dhe pozitive për seminarët. Me kërkesë të deputetëve do të mbahet edhe një seminar tjetër në shkurt të vitit 2005 me deputetë nga Komisioni evropian i Bundestagut gjerman, me ç'rast do të diskutohen çështje aktuale evropiane.

Përpos ngatërresave dhe vështërsive gjuhësore, gjatë komunikimit në gjuhën shqipe, serbe, angleze, frënge dhe gjermane: mund të thuhet se demokracia dhe puna parlamentare kanë shënuar përparime. Përbërja e re e Kuvendi mund të fillojë nga puna. Dhe ne ju dëshirojmë sukses në punë!

Dr. Rugova, Kryetarë i Kosovës i drejtohet Kuvendit në sesionin inagural më 3 dhjetor 2004

Pas zgjedhjes së tijë si Kryeminister i Kosovës më 3 dhjetor 2004 z. Ramush Haradinaj i shtrëgon doren tashmë ish Kryeministrit z. Bajram Rexhepit



Dr. Alush Gashi, kryesues i Grupit parlamentarë të LDK-së flet me z. Paskuale Salzano (Pasquale Salzano) Kryesuesin e Zyrës ndërlidhëse italiane gjatë mbrëmjes parlamentare më 24 nëntor 2004

Udhëheqësit e bashkësisë serbe së bashku me negociatorët nga Irlanda Veriore, Afrika e Jugut, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Ambasadori Petriq (Petritsch) dhe dr. Frishenshlager (Frischenschlager)
(shih atikullin në faqen 17)



Mes “dështimeve heroike” dhe involvimit aktiv

Andriani Mortoglou

Katërbëdhjetë përfaqësuesë të komunitetit serb të Kosovës udhëtuan për në Vjenë në mesin e dhjetorit 2004, me qëllim të inkurajimit të diskutimit dhe shqyrtimit të çështjeve kyçe me të cilat ballafaqohet komuniteti I tyre. Konferenca është mbajtur në vazhdimësi të ngjarjeve të organizuara në dhjetor të vitit 2003 në Austri me liderët e IPVQ-së – përfaqësuesit shqiptarë dhe të komuniteteve tjera.¹ Kjo ngjarje është mbajtur në bashkëpunim me “Projektin për Drejtësi në Kohën e Tranzicionit” me seli në Nju Jork dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme të Austrisë, Qendrën Ndërkombtare Olof Palme në Suedi dhe Misionin e OSBE-së në Kosovë.

E quajtur Përvetësimi i Strategjive për negociata dhe angazhim efektiv, konferenca pati për qëllim tu ofrojë përfaqësuesve të serbëve të Kosovës mundësinë e veçantë për të përfutur njohuritë nga negociatorët të lartë dhe udheheqës për mënyrat sesi ata në kontekste të tjera të pas-konflikteve iu qasën problemeve të ngjajshme, dhe cilat ishin mësimet e nxjerra nga këto qasje.

Nën moderimin e shkathtë të Ambasadorit austriak pranë Kombeve të Bashkuara në Gjenevë, Vollfgan Petritiq, dhe Friedhelm Frishenslager, ish drejtorin e Departamentit të Demokratizimit në Misionin e OSBE-së në Kosovë, praktikistë të dalluar ndërkombtar nga Afrika Jugore, Irlanda Veriore, Bosna dhe Hercegovina dhe

Kroacia² shkëmbyen mendimet e tyre në këtë takim 2 ditor me grupin serbë nga Kosova që në fakt ishin deputetë të parlamentit të Kosovës dhe përfaqësuesë të komunitetit.

Ata folën për përvojën e tyre të drejtëpërdrejtë në krijimin e një vizioni për të ardhmën, për të krijuar një marrëdhënie dhe një fuqi të përbashkët me palën tjetër, si dhe menaxhimin e të gjitha të priturve nga ky proces I kalimit prej konfliktit në negociata dhe zgjedhje të përheshme. Të shikosh armiqët e dikurshëm të ulur përreth një tryeze duke përshkruar procesin e transformimit të tyre në marreveshje dhe negociata ishte përvojë në vete. Një prej kontributeve më të mëdha ishin përvojat e shpalosura të Milorad Pupovacit, një deputeti serb të Kroacisë nga Sabori Kroat, i cili edhe luajti rol kyq në lehtësimin e riintegrit të serbëve të Kroacisë në Sllavinë Lindore.

Prezentimet treguan se shumë tema të shkoqitura mund të ishin të dobishme për pjesëmarrësitë serbë, dhe tu shërbenin si parametra për të ecur përpara, përkundër faktit që Kosova ngërthen një problematikë të llojit të vet, sikundër edhe secila situatë tjetër në botë. Negociatat mes ish palëve në konflikt është një proces i vështirë por i domosdoshëm: që kërkon që secila palë të fus veten në kpuçën e tjetrit, të jetë i gatshëm për kompromis

dhe të pranojë diçka më pak sesa që mund të jetë një zgjedhje ideale. Secila palë duhet të zhvillojë një vision për të ardhmën dhe të luftojë për të perms dialogut dhe participimit. Në këtë kuptim, të marrësh përsipër problemin dhe zgjedhjen adekuate është qenësore për të pasur sukses duke ndikuar në proces: “Nëse dëshironi që bota të duket ashtu siç dëshironi ju, atëherë involvohuni” janë fjalët e David Ervine, negociatorit të lartë nga Irlanda Veriore.

Mandati për të negociuar duhet dhënë populli liderëve të vet. Sidoqoftë, një lidhësi i vendosur dhe efektiv është qenësor për tju shmangur elementeve radikale dhe për të gjetur zgjidhje. Liderët duhet të jenë të hapur me votuesit lidhur me atë çfarë mund të arrijnë dhe të mos bien pre a pikëpamjeve të “dështimit heroik”. Dhe përfundimisht, koha e duhur është gjithashtu jetike për të gjetur një zgjidhje perms negociatave, një zgjedhje të qëndrueshme e cila prodhon një situatë në të cilën përfitojnë të gjitha palët.

Kjo ngjarje ofroi përfaqësuesve serbë të Kosovës, mundësinë për të diskutuar mes vete gjendjen e tanishme të komunitetit të tyre dhe të arrijnë më shumë koncensus mbi nevojat dhe prioritetet e tyre specifike para se të marrin në shqyrtim hapa të mëtejme. Brenga e tyre kryesore ishte siguria për komunitetin e tyre. Zhgënjimi i tyre me rezultatet e mangëta të pro-

cesit të kthimit dhe përvojat e tyre mbrenda IPVQ-së, ndjenja që nevojat e tyre po injorohen nga komuniteti shumicë, ishin arsye kryesore për mungesën e besimit dhe pajtimit mes dy komuniteteve. Në këtë kontekst pjesëmarrësitë diskutuan rolin e bashkësisë ndërkombtare dhe rëndësinë e angazhimit të saj si ndërmjetësues neutral mes tyre. U diskutuan gjithashtu eshte masat e rritjes së besimit të ndërsjellë, përfshirë edhe decentralizimin, dhe mënyrat sesi do të mund ky proces të krijojë besim mes komuniteteve. Grupi gjithashtu ka shqyrtuar rolin e rëndësishëm të Unionit Europian dhe nevojën e një vizioni për Kosovën në strukturat Europiane.

Zyrtarisht, gjatë konkluzioneve, dhe jozyrtarisht, gjatë ngjarjeve shoqërore, të gjithë pjesëmarrësit serbë shprehen falenderimet e tyre për organizimin. Ajo çfarë ata zgjedhën për të përfutur varet nga ata vet. Ndërsa sa i përket organizatorëve, po që se kjo ngjarje përbën një hap të vogël drejt zgjerimit të horizonteve të të menduarit të pjesëmarrësve është sukses në vete. Misioni i OSBE-së në Kosovë, Projekti mbi Drejtësinë në Kohën e Tranzicionit dhe Ministria e Punëve të Jashtme të Austrisë, të gjithë janë të përkushtuar që të ndihmojnë bisedimet mbrenda dhe mes gjitha komuniteteve në Kosovë.

¹ Shiko artikullin në Buletinin e ASI-it shkurt 2004.

² Pjesëmarrës ndërkombtarë ishin: Branko Damjanac, ish kryetar i komunës së Bërkqos, Bosna dhe Hercegovina; Ismail Ebrahim Ebrahim, Këshilltar politik i nënkryetarit të Afrikës Jugore; Kryesues i komisionit parlamentar për punë të jashtme; pjesëmarrës i lartë o negociatave shumë palëshe dhe anëtar i komisionit ekzekutiv të Kuvendit Nacional Afrikan; David Ervine, Negociator I Lartë gjatë bisedimeve që çuan në Marrëveshjen e së Premtes 1998 dhe zëdhënës i parties Progresive Unioniste të Irlandës Veriore; Seán Farren, Negociator i Partisë Social Demokrate dhe Partisë së Punës, ish deputet i Kuvendit të Irlandës Veriore dhe ish Minister i Financave; Roelf Meyer, ish kryesues i negociatave për qeverinë De Klerk dhe ish minister i çështjeve kushtetuese të Afrikës Jugore; dhe Milorad Pupovac, përfaqësues I minoritetit serbë të Kroacisë dhe anëtarë I komisionit parlamentar për Migrim, Refugjatë dhe Popullatë.

Programi i përbashkët përgatitor i ASI-t për përbërjen e re të Kuvendit

Ulrich Steinle

Përbërja e re e Kuvendit të Kosovës mund të vazhdojë punën bazuar në përvojën dhe profesionalizmin e fituar në tri vitet e kaluara. Shumica e anëtarëve të posazgjedhur kanë qenë edhe në mandatin e kaluar dhe që të gjithë anëtarët e Kuvendit përkrahen nga nga Sekretariati gjithnjë e më efikas i Kuvendit. Megjithatë, janë zgjedhur më shumë se 50 anëtarë pa përvojë të mëhershme parlamentare. Grupe të reja politike gjenden në Kuvend dhe sfida të reja politike gjenden para nesh. Kuvendi jo vetëm që do t'i zgjerojë kompetencat e veta në fushat e transferuara, por me praninë e koalicionit qeveritar dhe me grupe të vërteta opozitare do të duhet të mësohet me kulturën e re parlamentare dhe me rolet e reja.

Iniciativa për përkrahje të Kuvendit (ASI) e ka hartuar një program gjithëpërfshirës përgatitor për përbërjen e re të Kuvendit. Programi është përpiluar që t'i adresojë nevojat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit duke ofruar informata mbi të gjitha fushat me të cilat do të ballafaqohen politikanët/politikanet në Kosovë gjatë mandatit të tyre. Me njoftime mbi Rregulloren e punës, Sekretariatit e Kuvendit, punën me OJQ-të dhe marrëdhëniet me publikun, buxhetin e konsoliduar të Kosovës, institucionet dhe standardet e UE-së, punën e KFOR-it dhe dialogun regional ndërparlamentar – t'i përmendim vetëm disa nga modulet – programi përgatitor i ka adresuar aspektet kryesore teknike, procedurale dhe politike të punës parlamentare.



Programi përgatitor e reflekton në zhvillimin dhe zbatimin e vet qasjen e përbashkët të ASI-t. Kjo është zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë dhe dialog me partnerët e ASI-t, Kryesinë e Kuvendit, shefat e grupeve parlamentare, Sekretariatit e Kuvendit, qeverinë dhe organizatat e tjera ndërkombëtare. IPVQ-të kanë qenë të përfshira në masë të madhe gjatë zbatimit të programit, duke ofruar prezantime dhe duke u involvuar në diskutime me përvojën dhe profesionalizmin që e kanë zhvilluar gjatë këtyre viteve. Organizatat partnere të ASI-t i kanë bashkërenduar aktivitetet e tyre në mënyrë që t'i shmangen dyfishimit të punës dhe që t'i rregullojnë sa më shumë që është e mundur prezantimet e tyre përbrenda programit të përgjithshëm dhe në fushat përkatëse të veprimit të tyre.

Duke filluar nga ky program i përgjithshëm përgatitor, programe me të detajizuara dhe të specializuara për vitin 2005 do të diskutohen me anëtarët e Kuvendit për të ofruar përkrahje të duhur për Komisionet e Kuvendit dhe grupet parlamentare.

Data	Titulli	ASI partnerët
E enjte, 18 nëntor	-Njoftim për përbërjen e posazgjedhur të Kuvendit të Kosovës -Korniza Kushtetuese -Kuvendi për Kornizën Kushtetuese	-OSBE, NDI, konzorciumi i AER-it -Konzorciumi i AER-it -OSCE
E premte, 19 nëntor	-Rregullorja e punës -Sekretariati i Kuvendit të Kosovës dhe ndërtesa e Kuvendit	-NDI -Sekretariati i Kuvendit
E mërkurë, 24 nëntor	-Pranim parlamentar	-OSBE
E enjte, 25 nëntor	-Puna e Qeverisë (seanca e mëngjesit) -Mbikëqyrja e ekzekutivit (seanca e pasditës)	-OSBE / ZKM -NDI
E premte, 26 nëntor	-Legjislacioni ekonomik dhe komercial -Politikat sociale dhe legjislacioni social	-FNSt USAID/Bearing Point -FES, RIINVEST
E hënë, 29 nëntor	-Aspektet kryesore të statutit dhe puna e anëtarit të Kuvendit	-Konzorciumi i AER-it
E hënë, 6 dhjetor	-Funksionimi i institucioneve të UE-së dhe standardet europiane -Të drejtat dhe interesat e komuniteteve në Kuvend	-Shtylla IV (UE) dhe konzorciumi i AER-it -OSBE
E premte, 10 dhjetor	-Buxheti i konsoliduar i Kosovës për 2005 dhe BPK-ja -Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe dialogu regional	-Shtylla IV (UE) -OSBE
E shtunë, 11 dhjetor	-Puna e grupeve qeverisëse dhe atyre në opozitë në parlament	-EWPPP
E premte, 17 dhjetor	-SHPK dhe policia ndërkombëtare -Strukturat e KFOR-it dhe vlerësimi i sigurisë -Marrëdhëniet me votuesit, puna me OJQ-të dhe peticionet	-Komisioneri i policisë -Komandanti i KFOR-it -NDI
E mërkurë, 12 janar 2005	-Marrëdhëniet me media dhe të folurit publik -Ndërveprimi i qeverisjes qendrore dhe asaj lokale Zyra për Koordinimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe dialogut regional	-NDI -OSBE
E hënë, 17 janar 2005	-Diskutime mbi politikën dhe instrumentet ekonomike dhe mbi doganat -Ndërmarrjet shoqërore dhe ato publike -Vlerësimi i programit përgatitor, diskutime mbi përkrahjen e ardhshme të ASI-t për Kuvendin	-Shtylla IV (UE) -Shtylla IV (UE) -ë gjithë partnerët e ASI-t

Deputetët e Kuvendit të Kosovës të zgjedhur më 23 tetor 2004

33 KOALICIJA VAKAT

1 MURATI DŽEZAIR
2 IDRIZI SADIK
3 MURATI ŠPRESA

35 PARTIA SHQIPTARE DEMOKRISTIANE E KOSOVËS - PSHDK

1 KRASNIQI MARK
2 MORINA ZEF

37 GRAĐANSKA INCIIJATIVA SRBIJA

1 PETKOVIĆ SLAVIŠA
2 KUJUNDIŽIĆ ZLATICA

40 IRDK

1 HOTI BISLIM
2 NEZIRAJ XHEVDET

43 ORA

1 SURROI VETON
2 HYSA YLBER
3 MULHAXHA
KOLLÇAKU FATMIRE
4 GORANI GENC
5 MUHAXHERI
GAZMEND
6 SAHATQIJA TEUTA
7 JASHARI NAZIM

44 AAK - ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS

1 HARADINAJ RAMUSH
2 KOSUMI BAJRAM
3 HUNDOZI ZYLFIJE
4 MALOKU NAIM
5 ISUFI AHMET

6 DRESHAJ-BALIU MYRVETE
7 DUGOLLI BUJAR
8 QEKU ETHEM
9 SYLA GJYLNAZE

46 PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS

1 MERXHA ZYLFI
48 GIG - GRAĐANSKA
INCIIJATIVA GORE
1 IBIŠI RUSTEM

50 PDK - PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS

1 THAQI HASHIM
2 REXHEPI BAJRAM
3 BROVINA FLORA
4 KRASNIQI JAKUP
5 KUÇI HAJREDIN
6 DAUTI NERXHIVANE
7 HALITI XHAVIT
8 BAJRAMI ARSIM
9 HADRI TEUTA
10 HOXHAI ENVER
11 BUJA RAMË
12 AHMETAJ SALA
13 HYSENI - KALOSHI
HYDAJET
14 ARZUALLXHIU AFRIM
15 STATOVCI DRITA
16 MUJOTA FEHMI
17 XHEMAJLI BAJRUSH
18 SHALA SALA
19 HYSENI HAJREDIN
20 KOCI GANI
21 HADERGJONAJ SAFETE
22 HASANI NAIT
23 LIMA DEMIR
24 HALIMI SELVIJE
25 LUZHA BERAT
26 KRASNIQI EMIN
27 JUSUFI ZAHRIJE
28 CANZIBA XHELAL
29 BASHOTA SOKOL
30 HOXHA HATIXHE

52 LDK - LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS

1 RUGOVA IBRAHIM
2 BERISHA KOLË
3 KELMENDI NEKIBE
4 DACI NEXHAT
5 HAMITI SABRI
6 TËRMKOLLI MELIHATE
7 SEJDIU FATMIR
8 GASHI ALUSH
9 ALIAJ SANIJE
10 JERLIU NAIM
11 MUHAXHERI YMER
12 ZEQRAR SAMIJE
13 KRYEZIU FADIL
14 GECI FADIL
15 NIMANI REMZIJE
16 VULA FEHMI
17 REXHEPI FATMIR
18 MALOKU ZYHRIE
19 ALIMUSAJ NIMON
20 KELMENDI RAMADAN
21 HULAJ NURISHAHE
22 KRASNIQI AGIM
23 PIREVA ILAZ
24 BERISHA GJULSHEN
25 SHATRI HAKI
26 JONUZI IBUSH
27 BERISHA NAFIJE
28 ZENELI LULZIM
29 BRAJSHORI BEHXHET
30 KRYEZIU BRIKENDA
31 HALITI MILAZIM
32 MUSLIU RAMADAN
33 GAXHERRI BESA
34 REXHA NEXHAT
35 OSMANI NASER
36 DOÇI NAXHIJE
37 ZEKOLLI RAGIP
38 BERISHA FETAH
39 BUKOSHI RUDINA
40 ZHARKU LUTFI
41 HALIMI SHABAN
42 HOXHA QIBRIJE
43 KASTRATI JANUZ
44 GASHI FADIL
45 HYSENI LUMNIE

46 KAMBERI KAMBER
47 SUTAJ JUSUF

53 KDTP - KOSOVA DEMOKRATIK TÛRK PARTISI

1 YAĞCILAR MAHIR
2 KRASNIÇ RIFAT
3 MALTA NURAN

55 PARTIA E DREJTËSISË - PD

1 ÇERKEZI SYLEJMAN

56 PLK - PARTIA LIBERALE E KOSOVËS

1 DEDAJ GJERGJ

59 LËVIZJA POPULLORE E KOSOVËS - LPK

1 XHEMAJLI EMRUSH

PDAK - PARTIA DEMOKRATIKE E ASH- KANLIVE TË KOSOVËS

1 RRAHMANI SABIT

61 SDA - STRANKA DEMOKRATSKE AKCIJE

1 BALIĆ NUMAN

СЛKM - СПИСКА ЛИСТА ЗА КОСОВО И МЕТОХИЈУ

1 IVANOVIĆ OLIVER
2 NOJKIĆ RANĐEL
3 MILIĆ SNEŽANA
4 BOGDANOVIĆ GORAN
5 KRSTOVIĆ DRAGIŠA
6 JOVANOVIĆ VESNA
7 ILIĆ SLAĐAN
8 SAVIĆ GOJKO

Deklarata e Misionit të ASI-t

Si koordinatore e programeve për demokratizim për agjensitë që përkrahin Kuvendin e Kosovës, Iniciativa për Përkrahjen e Kuvendit (ASI) synon që ta forcojë dhe profesionalizojë Kuvendin e Kosovës në zhvillimin e aftësive në mënyrë që sa më parë të shndërrohet në një Kuvend stabil, funksional dhe efikas, i cili në vepron në përputhje me sundimin e ligjit dhe në mënyrë të barabartë në emër të të gjitha bashkësive dhe qytetarëve.

Anëtarët e iniciativës do të punojnë për t'i përqëndruar forcat e përbashkëta rreth një qëllimi të përbashkët që do të mundësojë përparimin në drejtim të arritjes së këtij pikësnyimi. Puna e ASI-it do të përqëndrohet në kulturën politike demokratike duke u mbështetur në njohuritë dhe respektimin e rregullave demokratike të procedurës, transparencën dhe përgjegjësinë ndaj popullit, në zbatimin e rendit legjislativ, mbikëqyrjen e ekzekutivit dhe në respektin ndaj shumëgjuhësisë në Kuvend.

Si një koordinatore në mes të agjensive që përkrahin Kuvendin e Kosovës, ASI përkrahë Kuvendin përmes konferencave dhe trajnimeve, seminareve me komisioneve, ndihmës teknike për Kryesinë, për krerët e komisioneve dhe për delegatët e Kuvendit, përmes vizitave të bëra parlamenteve të vendeve të ndryshme, trajnimeve për personelin legjislativ dhe për përkthyesit e Kuvendit. Përpos kësaj, edhe puna e këshilltarëve të Kuvendit dhe komisioneve të tij është pjesë e koordinimit të ASI-t.

Pjesëmarrësit e tanishëm të ASI-t:

Këshilli për Mbrojtjen e Drejtave dhe Lirive të Njeriut - KMDLNJ, Fondacioni Friedrich Ebert Stiftung (FES), Fondacioni Friedrich Naumann Stiftung (FNS), Konrad Adenauer Stiftung, Projekti për Praktikën Parlamentare Lindje-Perëndim (Holandë), Agjensioni Evropian për Rindërtim (AER), Agjensioni SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtarë (USAID) në bashkëpunim me Institutin Kombëtarë Demokratik (NDI), Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) në bashkëpunim me Unionin Ndërparlamentar (IPU), Departamenti i Demokratizimit i OSBE-së dhe Sekretariati i Kuvendit me përkrahjen aktive të zyrës së Kryeministrit, të zyrave të shtyllës së IV të UNMIK-ut UE-së dhe të zyrave përfaqësuese në Prishtinë, siç janë: zyra e Austrisë, Belgjikës, Gjermanisë, Italisë, Holandës, Zvicrës, Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.



<http://www.kuvendikosoves.org>
<http://www.skupstinakosova.org>
<http://www.assemblyofkosovo.org>

Fotografitë në këtë numër:

OSBE: pg. 1, 2, 16, 18, 20; NDI: pg. 9; UNMIK - DPI: 3; Kuvendi i Kosovës: 4,5,6,10,15.

Buletini informativ ASI dëshiron t'i falenderojë të gjithë ata që kontribuan si dhe Sven Lindholmin, njësinë e përkthimeve të DD pranë Misionit të OSBE-së në Kosovë, Lumni Rama and Edi Agagjyshi sepse pa përkrahjen e tyre ky Buletin informativ nuk do të ishte në dispozicionin tuaj.

ASI
NEWSLETTER

Rruga Beogradi 32, 38000 Prishtinë
 Tel. (+381-38) 500 162 Fax: (+381-38) 500 188
 kontakt: franklin.devrieze@osce.org
<http://www.osce.org/kosovo>

Pikëpamjet e shprehura nga ata që kontribuan në këtë buletin, iu përkasin vetëm atyre dhe jodomosdoshmërisht paraqesin pikëpamjet e Kuvendit, Misionit të OSBE-së në Kosovë apo të organizatave partnere të ASI-t